



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.109

2004

dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9334 datë 16.12.2004	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos të Konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike.....	7165
Ligj nr.9335 datë 16.12.2004	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin ndryshues të Konventës Europiane për televizionin ndërkufitar.....	7181
Ligj nr.9336 datë 16.12.2004	Për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për zhvillimin ndërkombëtar për projektin e menaxhimit të burimeve ujore.....	7190
Dekret nr.4440 datë 29.12.2004	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare	7200
	Ndreqje gabimi	7201

LIGJ
Nr.9334, datë 16.12.2004

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN E KIOTOS TË
KONVENTËS KUADËR TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR NDRYSHIMET
KLIMATIKE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 shkronja “b” të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin e Kiotos të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4445, datë 10.1.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

PROTOKOLLI I KIOTOS
PËR KONVENTËN KUADËR TË KOMBEVE TË BASHKUARA
PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

Palët në këtë protokoll,
duke qenë palë të Konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet klimatike, në vijim e përmendur si “Konventa”,
në zbatim të objektivit final të Konventës, i deklaruar në nenin 2 të saj,
duke kujtuar dispozitat e Konventës,
të udhëhequr nga neni 3 i Konventës,
në zbatim të Mandatit të Berlinit të miratuar nga vendimi 1/CP.1 i Konferencës së Palëve në sesionin e parë të saj,
kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Për qëllimet e këtij Protokolli, do të aplikohen përkufizimet që përfshihen në nenin 1 të Konventës. Përveç kësaj:

1. “Konferencë e Palëve” nënkupton Konferencën e Shteteve Palë të Konventës.
2. “Konventë” nënkupton Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet klimatike, të miratuar në Nju-Jork në datën 9 maj 1992.
3. “Paneli Ndërqeveritar mbi Ndryshimet Klimatike” nënkupton Panelin Ndërqeveritar mbi Ndryshimet Klimatike të krijuar në vitin 1988 bashkërisht nga Organizata Botërore e Metereologjisë dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin.
4. “Protokolli i Montrealit” nënkupton Protokollin e Montrealit mbi substancat që pakësojnë

shtresën e ozonit, miratuar në Montreal më 16 shtator 1987, i përshtatur dhe i ndryshuar më vonë.

5. “Palët e pranishme dhe votuese”, nënkupton palët e pranishme dhe që japin një votë pozitive ose negative.

6. “Palë” nënkupton një palë të këtij Protokolli, përjashtuar rastet kur konteksti është i ndryshëm.

7. “Palë e përfshirë në aneksin I” nënkupton një palë që përfshihet në aneksin I të Konventës, i cili mund të ndryshohet, ose një palë e cila ka bërë një njoftim në bazë të nenit 4 paragrafi 2(g) i Konventës.

Neni 2

1. Me qëllim që të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm dhe në përmbushjen e angazhimeve për kufizimin dhe reduktimin e emetimeve në bazë të nenit 3, secila nga palët e përfshira në aneksin I:

a) do të zbatojnë dhe/ose përpunojnë politika dhe masa të mëtëjshme në përputhje me rrethanat e tyre kombëtare, siç janë:

(i) rritja e efektivitetit të energjisë në sektorët përkatës të ekonomisë kombëtare;

(ii) mbrojtja dhe përmirësimi i baseneve dhe rezervuarëve të gazeve që shkaktojnë efektin serrë të cilat nuk kontrollohen nga Protokolli i Montrealit, duke pasur parasysh angazhimet e tyre në kuadrin e marrëveshjeve përkatëse në fushën e mjedisit; nxitjen e praktikave për administrimin e qëndrueshëm të pyjeve, pyllëzimin dhe ripyllëzimin;

(iii) nxitja e formave të qëndrueshme të bujqësisë duke pasur parasysh vlerësimet rreth ndryshimeve klimatike;

(iv) kërkimi dhe nxitja, zhvillimi dhe rritja e përdorimit të formave të reja dhe të rinovueshme të energjisë, të teknologjive të eliminimit të dioksidit të karbonit dhe të teknologjive pozitive të përparuara dhe novatore në drejtim të mjedisit;

(v) reduktimi progresiv ose mospërdorimi gradual i mallrave të papërshtatshme, stimuluesve fiskalë, përjashtimet nga taksat dhe tatimet dhe subvencionimet në të gjithë sektorët që emetojnë gaz që shkakton efektin serrë, të cilat veprojnë në kundërshtim me objektivat e Konventës dhe aplikimin e instrumenteve të tregut;

(vi) inkurajimi i reformave të përshtatshme në sektorët përkatës që synojnë nxitjen e politikave dhe masave që kufizojnë ose reduktojnë emetimin e gazeve që shkaktojnë efektin serrë dhe që nuk kontrollohen nga Protokolli i Montrealit;

(vii) masat që kufizojnë dhe/ose reduktojnë emetimet e gazeve që shkaktojnë efektin serrë që nuk kontrollohen nga Protokolli i Montrealit në sektorin e transportit;

(viii) kufizimi dhe/ose reduktimi i emetimeve të metanit nëpërmjet asgjësimit dhe përdorimit të shfrytëzimit të mbetjeve, si dhe në prodhimin, transportin dhe shpërndarjen e energjisë;

(ix) bashkëpunimi me shtetet e tjera palë për të rritur efektivitetin individual dhe të kombinuar të politikave dhe masave të tyre të miratuara në bazë të këtij neni, në mbështetje të nenit 4 paragrafi 2 (e)(i) të Konventës. Për pasojë, këto palë duhet të marrin masat për të dhënë eksperiencën e tyre dhe të shkëmbejnë informacion në lidhje me këto politika dhe masa, përfshirë mënyrat e zhvillimit të përmirësimit të krahasimit, transparencës dhe efektivitetit të tyre. Konferenca e Palëve, e cila shërben si një takim i palëve të këtij Protokolli, në sesionin e saj të parë ose sa më shpejt që të jetë e mundur pas saj, do të marrë në konsideratë mënyrat e lehtësimit të këtij bashkëpunimi, duke pasur parasysh të gjithë informacionin e nevojshëm.

2. Palët e përfshira në aneksin I duhet të zbatojnë kufizimin ose reduktimin e emisioneve të gazeve që shkaktojnë efektin serrë, që nuk kontrollohen nga Protokolli i Montrealit, nga cisternat e karburantit të aviacionit dhe marinës, që mbulohen respektivisht nga Organizata e Aviacionit Civil Ndërkombëtar dhe Organizata Ndërkombëtare e Detarisë.

3. Palët e përfshira në aneksin I do të përpiqen për të zbatuar masat dhe politikat në bazë të këtij neni në një mënyrë të tillë që të minimizojë efektet e kundërta, përfshirë efektet e kundërta të ndryshimeve klimatike, efektet e tregtisë ndërkombëtare dhe ndikimet sociale, mjedisore dhe ekonomike ndaj palëve të tjera dhe veçanërisht ato të identifikuara në nenin 4 paragrafi 8 dhe 9 të Konventës. Konferenca e Palëve, e cila shërben si takim i palëve të këtij Protokolli, mund të

ndërmarrë, kur është e nevojshme, veprime të mëtejshme për të nxitur zbatimin e dispozitave të këtij paragrafi.

4. Konferenca e Palëve që shërben si takim i palëve të këtij Protokolli, në qoftë se vendos se do të ishte i dobishëm koordinimi i çdonjëres prej politikave dhe masave të paragrafit 1(a) më lart, duke marrë parasysh rrethanat e ndryshme kombëtare dhe efektet potenciale, do të marrë në konsideratë mënyrat dhe mjetet për shtjellimin e koordinimit të këtyre politikave dhe masave.

Neni 3

1. Palët e përfshira në aneksin I, individualisht ose bashkërisht, do të sigurojnë që emetimet ekuivalente të agregatëve antropogjenikë të dioksidit të karbonit të gazeve që shkaktajnë efektin serrë, të listuara në aneksin A, nuk do të kalojnë sasi të tyre të paracaktuara, të llogaritura në përputhje me kufizimet sasiore të emetimeve dhe angazhimet e reduktimit të përshkruara në aneksin B dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni, me qëllim reduktimin e emetimeve të përgjithshme të këtyre gazeve të paktën 5% nën nivelet e vitit 1990 në periudhën e angazhimit 2008-2012.

2. Deri në vitin 2005, secila prej palëve të përfshira në aneksin I do të ketë bërë progres të dukshëm në arritjen e angazhimeve të saj në bazë të këtij Protokolli.

3. Ndryshimet në emetimet e gazeve që shkaktajnë efektin serrë nëpërmjet burimeve dhe mbetjeve nëpërmjet baseneve që rezultojnë nga ndryshimi i aktiviteteve të njeriut në ndryshimin e përdorimit të tokës dhe aktiviteteve në pyje që nga 1990, të matura si ndryshime të verifikueshme në stoqet e karbonit për secilën periudhë angazhimi, do të përdoret për të përmbushur angazhimet në bazë të këtij neni të secilës prej palëve të përfshira në aneksin I. Emetimet e gazit që shkaktajnë efektin serrë nga burimet dhe mbetjet e baseneve të shoqëruara me këto aktivitete do të raportohen në një mënyrë transparente dhe të verifikueshme dhe do të rishikohen në përputhje me nenet 7 dhe 8.

4. Përpara sesionit të parë të Konferencës së Palëve, që shërben si takim i palëve të këtij Protokolli, secila palë e përfshirë në aneksin I do t'i sigurojë të dhëna për vlerësim Organit Ndihmës për Këshillime Shkencore dhe Teknologjike, me qëllim për të përcaktuar nivelin e tij të stoqeve të karbonit në vitin 1990 dhe për të siguruar përllogaritjen që do të arrihet nga ndryshimet në stoqet e karbonit në vitet pasuese. Konferenca e Palëve që shërben si takim i palëve të këtij Protokolli, në sesionin e parë të saj ose sa më shpejt që të jetë e mundur më pas, do të vendosë për modalitetet, rregullat dhe orientimet lidhur me çështjen se si dhe cilat aktivitete shtesë të kryera nga dora e njeriut, që lidhen me ndryshimet në emetimet e gazit që shkakton efektin serrë nëpërmjet burimeve dhe mbetjeve të baseneve në dherat bujqësore dhe në ndryshimin e shfrytëzimit të tokës dhe kategoritë e pyjeve, do të shtohet ose të hiqen nga sasi të përcaktuara për palët e përfshira në aneksin I, duke pasur parasysh paqartësitë, transparencën në raportim, verifikueshmërinë dhe punën metodologjike të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike, asistencën e dhënë nga Organi Ndihmës Këshillimor për Shkencën dhe Teknologjinë në përputhje me nenin 5 dhe vendimet e Konferencës së Palëve. Një vendim i tillë do të aplikohet në periudhën e dytë dhe në periudhat e mëvonshme të angazhimit. Një palë mund të zgjedhë për të aplikuar një vendim të tillë përsa i përket aktiviteteve shtesë të kryera nga dora e njeriut për periudhën e saj të parë të angazhimit, me kusht që këto aktivitete të jenë kryer që nga viti 1990.

5. Palët e përfshira në aneksin I, që janë në procesin e transicionit në ekonominë e tregut, viti bazë ose periudha e të cilave është vendosur në zbatim të vendimit 9/CP.2 të Konferencës së Palëve në sesionin e dytë të saj, do të shfrytëzojnë atë vit ose periudhë bazë për zbatimin e angazhimeve të tyre në bazë të këtij neni. Çdo palë tjetër e përfshirë në aneksin I, që është në procesin e transicionit drejt ekonomisë së tregut, e cila nuk ka dorëzuar ende komunikimin e saj të parë kombëtar në bazë të nenit 12 të Konventës, mund të njoftojë gjithashtu Konferencën e Palëve që shërben si takim i palëve të këtij Protokolli dhe që synon të shfrytëzojë një vit ose periudhë historike bazë të ndryshme nga viti 1990 për zbatimin e angazhimeve në bazë të këtij neni. Konferenca e Palëve, që shërben si takim i palëve të këtij Protokolli, do të vendosë mbi pranimin e një njoftimi të tillë.

6. Duke marrë në konsideratë nenin 4 paragrafi 6 i Konventës, në zbatimin e angazhimeve

të tyre në bazë të këtij Protokolli, përveç atyre në bazë të këtij neni, do të lejohet një shkallë e caktuar fleksibiliteti nga Konferenca e Palëve që shërben si takim i palëve të këtij Protokolli të palëve të përfshira në aneksin I që janë në rrugën e transicionit drejt ekonomisë së tregut.

7. Në periudhën e parë të angazhimit për kufizimin dhe reduktimin e emetimit sasiar, nga viti 2008 deri në vitin 2012, sasia e caktuar për secilën palë të përfshirë në aneksin I do të jetë e barabartë me përqindjen e parashikuar për të në aneksin B të shumës së përgjithshme të emetimeve ekuivalente të dioksidit të karbonit antropogjenik të gazeve që shkaktjnë efektin serrë, të listuara në aneksin A në vitin 1990, ose në vitin ose periudhën bazë të përcaktuar në përputhje me paragrafin 5 më lart, shumëzuar me pesë. Këto palë të përfshira në aneksin I, për të cilat ndryshimi i tokës së përdorshme dhe pyjet përbënin një burim të mbetur në emetimin e gazeve që shkaktjnë efektin serrë në vitin 1990, do të përfshijnë në emetimet e tyre të vitit ose periudhës bazë të vitit 1990 të shumës së përgjithshme të emetimeve ekuivalente të dioksidit të karbonit antropogjenik nga burimet minus mbetjet nga basenet në vitin 1990 nga ndryshimi i tokës së përdorur për qëllimet e llogaritjes së sasisë së caktuar për ta.

8. Secila palë e përfshirë në aneksin I mund të përdorë vitin 1995 si vitin e saj bazë për hidrofluorokarburet, perfluorokarburet dhe sulfur hekzafluoridet, për qëllimet e përllogaritjes së përmendur në nenin 7 të mësipërm.

9. Angazhimet për periudhat e mëvonëshme për palët e përfshira në aneksin I, do të vendosen në ndryshimet që do t'i bëhen aneksit B të këtij Protokolli, të cilat do të miratohen në përputhje me dispozitat e nenit 21 paragrafi 7. Konferenca e shteteve palë që shërben si takim i palëve të këtij Protokolli do të iniciojë shqyrtimin e këtyre angazhimeve të paktën shtatë vjet para mbarimit të periudhës së parë të angazhimit të përmendur në paragrafin 1 të mësipërm.

10. Çdo njësi e reduktimit të emetimit, ose çdo pjesë e një sasi të përcaktuar, të cilën një palë e transferon në një palë tjetër në përputhje me dispozitat e nenit 6 ose të nenit 17, do të shtohet në sasinë e caktuar për palën marrëse.

11. Çdo njësi e reduktimit të emetimit, ose çdo pjesë e një sasi të përcaktuar, të cilën një palë e transferon në një palë tjetër në përputhje me dispozitat e nenit 6 ose të nenit 17, do të zbritet nga sasia e përcaktuar për palën transferuese.

12. Çdo reduktim i zyrtarizuar i emetimeve, të cilën një palë e merr nga një tjetër palë në përputhje me dispozitat e nenit 12, do t'i shtohet sasisë së përcaktuar për palën marrëse.

13. Në qoftë se emetimet e një pale të përfshirë në aneksin I në një periudhë angazhimi janë më të pakta sesa sasia e caktuar për të në bazë të këtij neni, kjo diferencë, me kërkesën e asaj pale, do të shtohet në sasinë e caktuar për atë palë për periudhat e mëvonshme të angazhimit.

14. Secila palë e përfshirë në aneksin I duhet të përpiket të përmbushë angazhimet e përmendura në paragrafin 1 më sipër, në mënyrë të tillë që të minimizojë ndikimet e padëshirueshme sociale, ekonomike, si dhe ato të mjedisit mbi palët e vendeve në zhvillim, veçanërisht ato të identifikuar në nenin 4 paragrafët 8 dhe 9 të Konventës. Në përputhje me vendimet përkatëse të Konferencës mbi zbatimin e atyre paragrafëve, Konferenca që shërben si mbledhje e palëve për këtë Protokoll, në seancën e parë duhet të konsiderojë marrjen e vendimeve që janë të nevojshme për minimizimin e pasojave të padëshirueshme në ndryshimin e klimës dhe/ose ndikimet si rrjedhojë e hapave të marra nga palët e përmendura në ato paragrafë. Ndër çështjet për t'u konsideruar do të jenë vendosja e fondeve, sigurimi dhe transferimi i teknologjisë.

Neni 4

1. Palët e përfshira në aneksin I, të cilat kanë arritur një marrëveshje për të përmbushur së bashku angazhimet sipas nenit 3, do të konsiderohen se kanë përmbushur këto angazhimeve duke u siguruar që shuma e përgjithshme e karbonit dioksid antropogjenik, ekuivalent me emetimin e gazeve që shkaktjnë efektin serrë të renditura në aneksin A, nuk do të kalojnë sasinë e përcaktuar, të llogaritura në përputhje me emetimin e tyre të limituar dhe me angazhimet për t'i pakësuar, të përshkruara në aneksin B në përputhje me dispozitat e nenit 3. Niveli përkatës i emetimit i lejuar për secilën palë në marrëveshje duhet të përcaktohet në atë marrëveshje.

2. Palët e një marrëveshjeje të tillë do të njoftojnë sekretariatin për kushtet e marrëveshjes

në datën e dorëzimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit të këtij Protokolli ose aderimit në të. Sekretariati nga ana tije do të informojë palët dhe nënshkruesit e Konventës mbi kushtet e marrëveshjes.

3. Çdo marrëveshje e tillë do të qëndrojë në zbatim për kohëzgjatjen e periudhës së angazhimit specifikuar në nenin 3 paragrafi 7.

4. Në qoftë se palët veprojnë në këtë mënyrë bashkërisht brenda kuadrit dhe në bashkëpunim me një organizatë rajonale të integritit ekonomik, çdo ndryshim në përbërjen e organizatës pas miratimit të këtij Protokolli nuk do të ndikojë në angazhimet ekzistuese sipas këtij Protokolli. Çdo ndryshim në përbërjen e organizatës zbatohet vetëm për qëllimet e atyre angazhimeve sipas nenit 3, të miratuara mbas atij ndryshimi.

5. Në rast të dështimit të palëve, në marrëveshje për të arritur shumën totale të nivelit të uljes të emetimit, secila palë e marrëveshjes do të jetë përgjegjëse për nivelin personal të emetimit të caktuar në marrëveshje.

6. Në qoftë se palët veprojnë së bashku brenda kuadrit dhe në bashkëpunim me një organizatë rajonale të integritit ekonomik, e cila është vetë palë e Protokollit, çdo shtet anëtar i asaj organizate rajonale të integritit ekonomik, në mënyrë individuale dhe së bashku me organizatën rajonale të integritit ekonomik që vepron në përputhje me nenin 24, në rast dështimi për të përmbushur shumën totale të nivelit të uljes të emetimit, janë përgjegjës për nivelin e tyre të emetimit të caktuar në përputhje me këtë nen.

Neni 5

1. Palët e përfshira në aneksin I do të caktojnë, jo më vonë se një vit përpara fillimit të periudhës së parë angazhuese, një sistem kombëtar për vlerësimin e emetimeve antropogjenike nëpërmjet burimeve dhe mbetjeve në basene të të gjitha gazeve që shkaktojnë efektin serrë të cilat nuk janë të kontrolluara nga Protokolli Montrealit. Udhëzimet për sisteme kombëtare të tilla, të cilat do të përfshijnë metodologjitë e përfshira në paragrafin 2 më poshtë, do të vendosen nga Konferenca e Palëve e cila shërben si mbledhje për palët në këtë Protokoll në seancën e parë.

2. Metodologjia për vlerësimin e emetimit antropogjenik nëpërmjet burimeve dhe mbetjeve nëpërmjet baseneve të të gjitha gazeve të efektit serrë të cilat nuk janë të kontrolluara nga Protokolli i Montrealit do të jenë ato të pranuar nga Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike, rënë dakord nga Konferenca e Palëve në sesionin e tretë të saj. Aty ku këto metodologji nuk janë përdorur, do të aplikohen modifikime të përshtatshme sipas metodologjive të përcaktuara nga Konferenca e Palëve që shërben si mbledhje për palët në këtë Protokoll në sesionin e parë. Bazuar mbi punën, *inter alia*, Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike, si dhe këshillat e dhëna nga Trupi Ndihmës për Këshillim Shkencor dhe Teknologjik, Konferenca e Palëve që shërben si takim për palët e këtij Protokolli, duhet rregullisht të kontrollojë dhe, ku është e përshtatshme, të rishikojë të tilla metodologji dhe rregullime, duke marrë plotësisht parasysh çdo vendim përkatës nga Konferenca e Palëve. Çdo rishikim i metodologjive dhe rregullimeve duhet të përdoret vetëm për qëllime të cilat sigurojnë përputhshmërinë me angazhimet sipas nenit 3 në lidhje me çdo periudhë angazhimi të miratuar pas atij rishikimi.

3. Potencialet e ngrohjes globale, përdorur për të llogaritur ekuivalentin e dioksidit të karbonit me atë të emetimit antropogjenik nëpërmjet burimeve dhe mbetjeve nëpërmjet baseneve të gazeve të efektit serrë të përmendura në aneksin A, do të jenë ato të pranuar nga një Panel Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike dhe të rëna dakord nga Konferenca e Palëve në seancën e tretë. Bazuar mbi punën, *inter alia*, Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike dhe këshillat e dhëna nga Trupi Ndihmës për Këshilla Shkencore dhe Teknologjike, Konferenca e Palëve shërben si mbledhje e Palëve në Protokoll, do të rishikojë rregullisht dhe ku është e përshtatshme të rishikojë potencialin e ngrohjes globale të secilit prej këtyre gazeve të efektit serrë, duke pasur parasysh vendimet përkatëse të Konferencës së Palëve. Çdo rishikim i potencialit të ngrohjes globale do të aplikohet vetëm ndaj angazhimeve sipas nenit 3 duke respektuar çdo periudhë angazhimi të miratuar pas këtij rishikimi.

Neni 6

1. Me qëllim që të përmbushë detyrimet sipas nenit 3, çdo palë e përfshirë në aneksin I mund të transferojë në, apo marrë nga, çdo palë tjetër njësitë e zvogëlimit të emetimit që rezultojnë nga projekte të cilat mund të ulin emetimet antropogjenike nga burimet apo për të rritur emetimet antropogjenike nëpërmjet burimeve dhe mbetjeve nëpërmjet baseneve në çdo sektor të ekonomisë, me kusht që:

- a) çdo projekt i tillë ka miratimin e palëve të përfshira;
- b) çdo projekt i tillë siguron një ulje të emetimeve nga burime ose një intensifikim të mbetjeve nëpërmjet baseneve, përveç asaj që do të ndodhte në rastin e kundërt;
- c) nuk përfiton ndonjë njësi të zvogëlimit të emetimit në qoftë se nuk është në përputhje me detyrimet e kërkuara sipas nenit 5 dhe 7; dhe
- d) sigurimi i njësive të zvogëlimit të emetimit do të jetë plotësues i aktiviteteve të brendshme me qëllim për të arritur angazhimet sipas nenit 3.

2. Konferenca e Palëve që shërben si mbledhje për palët e këtij Protokolli, në sesionin e parë apo sa më parë të mundet dhe të jetë e praktikueshme më pas, mund të zhvillojnë më tej udhëzimet për zbatimin e këtij neni, përfshirë verifikimin dhe raportimin.

3. Një palë e përfshirë në aneksin I mund të autorizojë persona juridikë për të marrë pjesë, nën përkujdesjen e saj, në veprimet që çojnë në gjenerimin, transferimin apo përvetësimin sipas këtij neni të njësive të zvogëlimit të emetimit.

4. Në qoftë se një problem, gjatë zbatimit nga një palë e përfshirë në aneksin I nga kërkesat e përmendura në këtë nen, identifikohet në përputhje me klauzolat përkatëse të nenit 8, transfertat dhe përvetësimi i njësive të uljes së emetimit mund të vazhdojë të bëhet pasi çështja është identifikuar, me kusht që çdo njësi e tillë të mos përdoret nga palët për të përmbushur angazhimet sipas nenit 3, derisa çështja e përputhmërisë të zgjidhet.

Neni 7

1. Secila palë e përfshirë në aneksin I duhet të përfshijë në inventarin vjetor të emetimeve antropogjenike, nëpërmjet burimeve dhe mbetjeve nëpërmjet baseneve të gazeve të efektit serrë të pakontrolluara nga Protokolli i Montrealit, të dorëzuara në përputhje me vendimet përkatëse të Konferencës së Palëve, informacionin e duhur shtesë për të siguruar pajtimin me nenin 3, për t'u caktuar në përputhje me paragrafin 4, më poshtë.

2. Secila palë e përfshirë në aneksin I duhet të përfshijë në komunikimin kombëtar, të dorëzuar sipas nenit 12 të Konventës, informacion të nevojshëm dhe plotësues për të treguar përputhshmërinë me angazhimet sipas këtij Protokolli, për t'u vendosur në përputhje me paragrafin 4 më poshtë.

3. Çdo palë e përfshirë në aneksin I duhet të dorëzojë informacionin e kërkuar sipas paragrafit 1 më lart, duke filluar nga inventari i parë i kërkuar nga Konventa për vitin e parë të periudhës së angazhimit pasi Protokolli ka hyrë në fuqi për atë palë. Çdo palë e tillë duhet të dorëzojë informacionin e kërkuar sipas paragrafit 2 më sipër, si pjesë e komunikimit të parë nacional të kërkuar nga Konventa pasi ky Protokoll ka hyrë në fuqi për të dhe pas miratimit të udhëzimeve të dhëna në paragrafin 4 më poshtë. Frekuenca e paraqitjes së mëtejshme të informacionit të kërkuar nga ky nen do të përcaktohet nga Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokolli, duke marrë parasysh kohët e përcaktuara për dorëzimin e komunikimeve kombëtare të përcaktuara nga Konferenca e Palëve.

4. Konferenca e Palëve që shërben si mbledhje për palët e këtij Protokolli do të miratojë gjatë seancës së parë dhe do rishikojnë në mënyrë periodike më pas udhëzimet për përgatitjen e informacionit të kërkuar sipas këtij neni, duke marrë parasysh udhëzimet për përgatitjen e komunikimeve kombëtare nga palët të përfshira në aneksin I, miratuar nga Konferenca e Palëve. Konferenca e Palëve që shërben si mbledhje për palët e këtij Protokolli, gjithashtu, para periudhës fillestare të angazhimit, do të përcaktojë modalitetet për llogaritjen e shumave të caktuara.

Neni 8

1. Informacioni i dorëzuar sipas nenit 7 nga secila palë e përfshirë në aneksin I do të rishikohet nga grupe eksperte, në përputhje me vendimet përkatëse të Konferencës së Palëve dhe në përputhje me udhëzimet e miratuara për këtë qëllim nga Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokolli sipas paragrafit 4 më poshtë. Informacioni i dorëzuar sipas nenit 7 paragrafi 1, nga secila Palë e përfshirë në aneksin I, do të rishikohet si pjesë e përpilimit dhe llogaritjeve vjetore të inventarit të emetimeve dhe shumave të caktuara. Gjithashtu, informacioni i dorëzuar sipas nenit 7 paragrafi 2, nga secila palë e përfshirë në aneksin I, do të rishikohet si pjesë e rivlerësimit të komunikimeve.

2. Grupet eksperte të shqyrtimit do të koordinohen nga sekretariati dhe do të përbëhen nga ekspertë të përzgjedhur prej atyre të emëruar nga palët e Konventës dhe, ku është e përshtatshme, nga shoqata ndërqeveritare, në përputhje me direktivat e dhëna për këtë qëllim nga Konferenca e Palëve.

3. Procesi i shqyrtimit do të japë një vlerësim teknik të plotë dhe të gjithanshëm të të gjitha aspekteve të zbatimit nga një palë e këtij Protokolli. Grupet eksperte të shqyrtimit do të përgatisin një raport të Konferencës së Palëve, që shërben si mbledhje e palëve në këtë Protokoll, duke vlerësuar zbatimin e angazhimeve të palëve dhe duke identifikuar çdo potencial për problem në, dhe në faktorët që ndikojnë plotësimin e angazhimeve. Këto raporte do të qarkullojnë nga sekretariati te të gjitha palët e Konventës. Sekretariati do të shënojë ato pyetje të zbatimit të treguara në këto raporte për shqyrtim të mëtejshëm nga Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhje për palët në këtë Protokoll.

4. Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhje për palët e këtij Protokolli, do të miratojë gjatë seancës së parë dhe do të rishikojë në mënyrë periodike më tej udhëzimet për rishikimin e zbatimit të Protokollit nga grupet eksperte të shqyrtimit duke marrë parasysh vendimet përkatëse të Konferencës së Palëve.

5. Konferenca e Palëve që shërben si mbledhje për Palët e këtij Protokolli, me ndihmën e Organit Ndihmës për Zbatimin dhe të Organit Ndihmës për Këshilla Shkencorë dhe Teknologjikë, kur është e përshtatshme, do të shqyrtojë:

a) informacionin e dorëzuar nga palët sipas nenit 7 dhe raportet e rishikimeve të ekspertëve të kryera sipas këtij neni; dhe

b) çështjet mbi zbatimin, të shënuara nga sekretariati sipas paragrafit 3 më sipër, si dhe çështjet e ngritura nga palët.

6. Në përputhje me shqyrtimin e informacionit të përmendur në paragrafin 5 më lart, Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhje për palët në këtë Protokoll, do të marrë vendime në çdo çështje të kërkuar për zbatimin e Protokollit.

Neni 9

1. Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhje për palët e këtij Protokolli, do të rishikojë periodikisht këtë Protokoll, duke marrë parasysh informacionin shkencor më të mirë dhe të disponueshëm dhe vlerësimet mbi ndryshimet klimatike dhe rrjedhojat e saj, si dhe informacionet teknike, sociale dhe ekonomike të cilat kanë lidhje me çështjen. Këto rishikime do të koordinohen me rishikimet përkatëse sipas Konventës, në veçanti me ato të kërkuara nga neni 4 paragrafi 2 (d) dhe neni 7 paragrafi 2 (a) i Konventës. Duke u bazuar mbi këto rishikime, Konferenca e Palëve që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokolli do të marrë masat e duhura.

2. Rishikimi i parë do të zhvillohet në seancën e dytë të Konferencës së Palëve, e cila shërben si mbledhje për palët e këtij Protokolli. Rishikimet e mëpasshme do të zhvillohen në intervale të rregullta në kohë të caktuara.

Neni 10

Të gjitha palët, duke marrë parasysh detyrat e përbashkëta por njëkohësisht të diferencuara, si dhe prioritetet e tyre specifike të zhvillimit kombëtar dhe rajonal, objektivat dhe rrethanat, pa paraqitur angazhime të reja për palët të cilat nuk janë të përfshira në aneksin I, por rimiratojnë

angazhimet ekzistuese sipas nenit 4 paragrafi 1 të Konventës dhe vazhdojnë të përparojnë në zbatimin e këtyre angazhimeve në mënyrë të tillë që të arrijnë zhvillim të qëndrueshëm, duke marrë parasysh nenin 4 paragrafët 3, 5 dhe 7 të Konventës:

a) duhet të formulojnë, aty ku është e mundur dhe e përshtatshme, programe me kosto efektive kombëtare dhe rajonale për të përmirësuar cilësinë e faktorëve të emetimeve vendore, të dhënat e aktiviteteve dhe/ose modele, të cilat reflektojnë kushtet sociale dhe ekonomike të secilës palë për përgatitjen dhe përmirësimin periodik të inventarit kombëtar të emetimeve antropogjenike nëpërmjet burimeve dhe mbetjeve nëpërmjet baseneve të të gjitha gazeve që shkaktojnë efektin serrë të pakontrolluara nga Protokollin i Montrealit, duke përdorur metodologji të krahasueshme, për të cilat duhet të vendoset në Konferencën e Palëve dhe në përputhje me udhëzimet për përgatitjen e njoftimeve kombëtare të miratuara nga Konferenca e shteteve palë;

b) duhet të formulojnë, zbatojnë, publikojnë dhe të rinovojnë rregullisht programet kombëtare dhe, aty ku është e përshtatshme, programet rajonale të cilat përfshijnë masa për përmirësimin e ndryshimeve klimatike, si dhe masa për lehtësimin e përshtatjes sa më të mirë me ndryshimet klimatike:

i) Këto programe mund të ndërmerren, ndër të tjera, në fushën e energjisë, transportit dhe sektorëve të industrisë, si dhe në bujqësi, pyje dhe administrimin e mbetjeve. Gjithashtu, teknologjitë e përshtatjes dhe metodat për përmirësimin e planifikimit hapësinor mund të përmirësojnë përshtatjen në lidhje me ndryshimet klimatike; dhe

ii) Palët e përfshira në aneksin I do të japin informacione, duke përfshirë programet kombëtare mbi masat e marra në përputhje me nenin 7 të këtij Protokollit; dhe shtetet e tjera palë do të përpiqen të përfshijnë në komunikimet e tyre kombëtare, aty ku është e përshtatshme, informacion mbi programet që përmbajnë masa, të cilat sipas shteteve palë, kontribuojnë në adresimin e problemeve në lidhje me ndryshimet klimatike dhe ndikimeve të saj të padëshiruara, duke përfshirë uljen e rritjes së emetimit të gazeve që ndikojnë në efektin serrë, si dhe mbetjeve nëpërmjet baseneve dhe zgjerimin e ngritjen e kapaciteteve dhe masave përshtatëse.

c) duhet të bashkëpunojnë në nxitjen e mënyrave efektive për zhvillimin, zbatimin dhe shpërndarjen e teknologjive të ndjeshme për mjedisin, njohurive, praktikave dhe proceseve në lidhje me ndryshimet klimatike në veçanti për vendet në zhvillim, si dhe të ndërmarrin të gjitha hapat praktike për nxitjen, lehtësimin, financimin, transferimin ose mundësimin e teknologjive të mësipërme, duke përfshirë formulimin e politikave dhe programeve për transferimin e teknologjive mjedisore të ndjeshme të cilat ndodhen në pronësi publike ose në fusha publike dhe krijimin e mundësive për sektorin privat në drejtim të nxitjes, zgjerimit, transferimit dhe aksesit në teknologjitë e ndjeshme për mjedisin;

d) duhet të bashkëpunojnë në kërkimet shkencore dhe teknike dhe të nxisin mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemeve sistematike të vëzhgimit, si dhe zhvillimin e bazave të të dhënave për minimizimin e paqartësive që lidhen me sistemin klimatik, ndikimet e padëshiruara në ndryshimet klimatike dhe pasojat ekonomike dhe sociale të strategjive të ndryshme për këtë qëllim, si dhe nxitjen e zhvillimit dhe forcimin e kapaciteteve dhe aftësive të mirëfillta për të marrë pjesë në përpjekjet, programet dhe rrjetet ndërkombëtare dhe ndërqeveritare mbi kërkimet dhe vëzhgimin sistematik, duke mbajtur parasysh nenin 5 të Konventës;

e) duhet të bashkëpunojnë në nxitjen e zhvillimit dhe zbatimin e programeve të arsimit dhe trajnimit në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve kombëtare, në veçanti kapacitetet njerëzore dhe institucionale dhe shkëmbimin e personelit për të trajnuar ekspertë në këtë fushë, në veçanti për vendet e zhvilluara dhe lehtësimin e informacionit për publikun në nivel kombëtar mbi ndryshimet klimatike, duke përdorur organet ekzistuese aty ku kjo gjë paraqitet e përshtatshme. Nëpërmjet organeve përkatëse të Konventës duhet të zhvillohen modalitete të përshtatshme për zbatimin e këtyre aktiviteteve, duke marrë parasysh nenin 6 të Konventës;

f) duhet të përfshijnë në komunikimet e tyre kombëtare informacion mbi programet dhe aktivitetet e ndërmarra sipas këtij neni, në përputhje me vendimet përkatëse të Konferencës së shteteve palë; dhe

g) duhet të marrin parasysh nenin 4 paragrafi 8 i Konventës në zbatimin e angazhimeve që rrjedhin nga ky nen.

Neni 11

1. Në zbatimin e nenit 10, palët duhet të mbajnë parasysh dispozitat e nenit 4 paragrafët 4, 5, 7, 8 dhe 9 të Konventës.

2. Në kontekstin e zbatimit të nenit 4 paragrafi 1 i Konventës, në përputhje me dispozitat e nenit 4 paragrafi 3 dhe nenit 11 të Konventës, si dhe nëpërmjet organit apo organeve të cilave u janë besuar veprimi me mekanizmat financiarë të Konventës, shtetet palë të zhvilluara dhe palët e tjera të zhvilluara të përfshira në aneksin II të Konventës:

a) do të sigurojnë burime financiare të reja dhe shtesë për arritjen e kostos së plotë që nevojitet për shtetet palë në zhvillim, në zbatimin e angazhimeve ekzistuese sipas nenit 4 paragrafi 1(a) të Konventës që mbulohet nga neni 10 nënparagrafi (a); dhe

b) gjithashtu do të sigurojnë burime të tilla financiare, duke përfshirë edhe ato që i nevojiten shteteve palë në zhvillim për transferimin e teknologjisë, me qëllim arritjen e kostos së plotë të shtuar për të cilën është rënë dakord dhe zbatimin e angazhimeve ekzistuese sipas nenit 4 paragrafi 1 i Konventës, të cilat mbulohen nga neni 10, për të cilat është rënë dakord ndërmjet një shteti palë në zhvillim dhe organit apo organeve ndërkombëtare të cilave i referohet neni 11 i Konventës, në përputhje me atë nen.

Zbatimi i këtyre angazhimeve ekzistuese do të marrë parasysh nevojën për mjaftueshmërinë dhe parashikueshmërinë në rrjedhjen e fondeve dhe rëndësinë e ndarjes së barrës financiare në mënyrë të përshtatshme ndërmjet shteteve palë të zhvilluara. Ndihma për organin apo organet e ngarkuara me veprimet e mekanizmave financiarë të Konventës në vendimet e Konferencës së Palëve, duke përfshirë edhe ato për të cilat është rënë dakord para miratimit të këtij Protokolli, do të zbatohen *mutatis mutandis* në dispozitat e këtij paragrafi.

3. Shtetet palë të zhvilluara dhe palët e tjera të zhvilluara në aneksin II të Konventës gjithashtu mund të sigurojnë burime financiare nëpërmjet kanaleve dypalëshe, rajonale apo shumëpalëshe për shtetet palë në zhvillim.

Neni 12

1. Një mekanizëm zhvillimi i pastër është përkufizuar në vijim.

2. Qëllimi i një mekanizmi të zhvillimit të pastër do të jetë që të ndihmojë palët të cilat nuk janë përfshirë në aneksin I në arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe kontributi për qëllimin final të Konventës, si dhe të ndihmojë palët e përfshira në aneksin I në arritjen e objektivave për kufizimet në emetimit të gazrave dhe angazhimet për zvogëlimin e tyre sipas nenit 3.

3. Sipas mekanizmit të zhvillimit të pastër:

a) palët që nuk janë përfshirë në aneksin I do të përfitojnë nga aktivitetet e projektit që do të rezultojnë në njohjen e certifikuar të reduktimit të emetimeve; dhe

b) palët e përfshira në aneksin I mund ta përdorin njohjen e certifikuar të reduktimit të emetimeve duke përfituar nga këto aktivitete të projektit, të cilat kontribuojnë në plotësimin e një pjese të detyrimeve të tyre për kufizimin e emetimit në përputhje me nenin 3, ashtu siç përcaktohet nga Konferenca e shteteve palë që shërben si mbledhje e shteteve palë të këtij Protokolli.

4. Mekanizmi i një zhvillimi të pastër do të drejtohet dhe administrohet nga Konferenca e Palëve që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokolli dhe do të mbikëqyret nga ana e një bordi ekzekutiv e mekanizmit të zhvillimit të pastër.

5. Kufizimet e emetimit që rezultojnë nga çdo aktivitet projekti, do të zyrtarizohen nga organe operationale që caktohen nga Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhja e palëve të këtij Protokolli, mbi bazën e:

a) pjesëmarrjes vullnetare e miratuar nga të gjitha palët e përfshira;

b) përfitimeve të vërteta, të matshme dhe afatgjata që lidhen me përmirësimin e ndryshimeve klimatike; dhe

c) reduktimin të emetimeve të cilat ndodhin në të gjithë botën, në mungesë të një projekti të zyrtarizuar.

6. Mekanizmi i zhvillimit të pastër do të ndihmojë sipas nevojës në gjetjen e fondeve për

aktivitetet në kuadrin e projekteve të zyrtarizuara.

7. Në mbledhjen e saj të parë, Konferenca e Palëve, e cila shërben edhe si mbledhje e palëve të këtij Protokolli, do të përpunojë modalitetet dhe procedurat me qëllim sigurimin e transparencës, efencës dhe dhënien e llogarisë nëpërmjet një kontrolli dhe verifikimi të pavarur të aktiviteteve në kuadrin të projekteve.

8. Duke shërbyer si mbledhje e palëve të këtij Protokolli, Konferenca e Palëve do të bëjë të mundur që një pjesë e përfitimit nga aktivitetet në kuadrin të projekteve të zyrtarizuara të përdoret për mbulimin e shpenzimeve administrative, si dhe të ndihmojë shtetet palë në zhvillim, të cilat janë veçanërisht të ndjeshme nga efektet e dëmshme të ndryshimeve klimatike, për mbulimin e kostos së përshtatjes.

9. Pjesëmarrja në mekanizmin e zhvillimit të pastër, duke përfshirë edhe aktivitetet e përmendura në paragrafin e mësipërm 3(a), si dhe në arritjen e reduktimeve të zyrtarizuara të emetimit të gazit, mund të përfshijë subjekte private dhe/ose publike dhe drejtimi i tyre mund të sigurohet nga bordi ekzekutiv i mekanizmit të zhvillimit të pastër.

10. Reduktimet zyrtare të emetimit të arritura gjatë periudhës nga viti 2000 deri në fillimin e periudhës së parë të angazhimit mund të përdoren në arritjen e objektivave të periudhës së parë të angazhimit.

Neni 13

1. Konferenca e Palëve, organi më i lartë i Konventës, do të shërbejë edhe si mbledhje e palëve të këtij Protokolli.

2. Palët e Konventës që nuk janë palë në këtë Protokoll, mund të marrin pjesë si vëzhgues në punimet e çdo sesiioni të Konferencës së Palëve, që shërben edhe si mbledhje e palëve të këtij Protokolli. Kur Konferenca e Palëve shërben edhe si mbledhje e palëve të këtij Protokolli, vendimet sipas këtij Protokolli do të merren vetëm nga palët e këtij Protokolli.

3. Kur Konferenca e Palëve shërben edhe si mbledhje e palëve të këtij Protokolli, çdo anëtar i Byrosë së Konferencës së shteteve palë, të cilat përfaqësojnë një palë në Konventë, por që në të njëjtën kohë nuk janë palë e këtij Protokolli, do të zëvendësohen nga një anëtar shtesë, i cili zgjidhet nga/dhe ndërmjet palëve të këtij Protokolli.

4. Konferenca e Palëve, e cila shërben edhe si mbledhje e palëve të këtij Protokolli, do të rishikojë rregullisht zbatimin e këtij Protokolli dhe do të marrë brenda kompetencave vendimet e nevojshme për nxitjen e zbatimit efektiv të tyre. Gjithashtu, ajo do të kryejë funksionet që i janë ngarkuar nga ky Protokoll dhe:

a) do të ndihmojë palët e Protokollit në zbatimin e Protokollit, mbi bazën e informacionit që merret në përputhje me dispozitat e këtij Protokolli, për ndikimin e masave të përgjithshme të marra sipas këtij Protokolli, në veçanti efektet mjedisore, ekonomike dhe sociale, si dhe ndikimin e tyre kumulativ, si dhe masën e progresit që është arritur në drejtim të objektivave të Konventës;

b) do të shqyrtojë periodikisht detyrimet e palëve mbi bazën e Protokollit, duke i dhënë rëndësinë e duhur çdo rishikimi që parashikohet nga neni 4 paragrafi 2(d) dhe neni 7 paragrafi 2 i Konventës, në përputhje me objektivat e Konventës dhe eksperiencën e përfutur në zbatimin e saj, si dhe evoluimin e njohurive shkencore dhe teknike, duke miratuar rregullisht raporte mbi zbatimin e këtij Protokolli;

c) do të nxisë dhe do të lehtësojë shkëmbimin e informacionit mbi masat e miratuara nga palët në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe efekteve të saj, duke marrë parasysh rrethanat e ndryshme, përgjegjësitë dhe aftësitë e shteteve palë, si dhe angazhimet e tyre respektive në bazë të këtij Protokolli;

d) do të lehtësojë, mbi bazën e kërkesës të dy ose më shumë palëve, koordinimin e masave të miratuara nga ata për t'iu përgjigjur ndryshimeve klimatike dhe efekteve të saj, duke marrë parasysh rrethanat e ndryshme, përgjegjësitë dhe aftësitë e palëve, si dhe angazhimet e tyre respektive në bazë të këtij Protokolli;

e) do të nxisë dhe do të drejtojë, në përputhje me objektivat e Konventës dhe dispozitat e

këtij Protokollit dhe duke marrë plotësisht parasysh vendimet e Konferencës së Palëve, zhvillimin dhe përmirësimin periodik të metodologjive të krahasueshme për zbatimin efektiv të këtij Protokollit, për të cilën do të bihet dakord nga Konferenca e Palëve që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokollit;

f) do të japë rekomandime mbi çdo çështje që është e nevojshme për zbatimin e këtij Protokollit;

g) do të vlerësojë mundësinë e angazhimit të burimeve financiare shtesë, në përputhje me nenin 11 paragrafi 2;

h) do të formojnë organet e duhura vartëse, të cilat konsiderohen të nevojshme për zbatimin e këtij Protokollit;

i) do të kërkojë dhe përdorë, aty ku është e nevojshme, shërbimet, bashkëpunimin dhe informacionin e siguruar nga organizatat kompetente ndërkombëtare, si dhe nga organet ndërqeveritare dhe joqeveritare; dhe

j) do të kryejë funksionet e tjera, sipas nevojës, për zbatimin e Protokollit, si dhe do të marrë parasysh çdo detyrë dalë nga një vendim i Konferencës së Palëve.

5. Rregullat e procedurës të Konferencës së Palëve dhe procedurat financiare që zbatohen mbi bazën e Konventës do të aplikohen *mutatis mutandis* mbi bazën e këtij Protokollit, përveç rasteve kur Konferenca e Palëve, e cila shërben edhe si mbledhje e palëve të këtij Protokollit, vendos ndryshe me konsensus.

6. Sesioni i parë i Konferencës së Palëve, e cila shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokollit, do të mbledhet nga sekretariati duke e kombinuar me sesionin e parë të Konferencës së Palëve e cila është vendosur të zhvillohet pas datës së hyrjes në fuqi të këtij Protokollit. Sesionet e zakonshme vijuese të Konferencës së Palëve, që shërbejnë edhe si mbledhje të palëve të këtij Protokollit, do të mbahen çdo vit në kombinim me sesionet e zakonshme të Konferencës së Palëve, nëse nuk vendoset ndryshe nga Konferenca e Palëve e cila shërben si mbledhje e Palëve të këtij Protokollit.

7. Sesionet e jashtëzakonshme të Konferencës së Palëve, e cila shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokollit, do të mbahen në kohën në të cilën ato konsiderohen të nevojshme nga Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokollit, ose mbi bazën e një kërkesë me shkrim nga çdo Palë dhe nëse 6 muaj nga njoftimi i kësaj kërkesë nga ana e sekretariatit të palëve, kjo kërkesë merr mbështetjen e të paktën një të tretës së palëve.

8. Organizata e Kombeve të Bashkuara, agjencitë e saj të specializuara dhe Agjencia Ndërkombëtare për Energjinë Atomike, si dhe çdo shtet zyrtarisht palë apo jo e Konventës mund të përfaqësohen si vëzhgues në sesionet e Konferencës së Palëve që shërben si mbledhje e palëve të Protokollit. Çdo organ apo agjenci kombëtare apo ndërkombëtare, qeveritare apo jo, e cila vepron në çështje të mbuluara nga ky Protokoll dhe që ka njoftuar sekretariatit për dëshirën e tij për t'u përfaqësuar në një sesion të Konferencës së Palëve, që shërben si takim i palëve të këtij Protokoll si një vëzhgues, mund të pranohet kështu, përveçse kur të paktën një e treta e palëve prezente është kundër. Pranimi dhe pjesëmarrja e vëzhguesve do të jetë objekt i rregullave të procedurës, siç referohet në paragrafin 5 më lart.

Neni 14

1. Sekretariati i ngritur sipas nenit 8 të Konventës do të shërbejë si sekretariat i këtij Protokollit.

2. Neni 8 paragrafi 2 i Konventës mbi funksionet e sekretariatit dhe neni 8 paragrafi 3 i Konventës mbi rregullimet e bëra për funksionimin e sekretariatit, do të zbatohet *mutatis mutandis* në këtë Protokoll. Sekretariati, si shtesë, do të ushtrojë funksionet e dhëna atij nën këtë Protokoll.

Neni 15

1. Organi Ndihmës për Këshillim Shkencor dhe Teknologjik dhe Organi Ndihmës për Zbatimin, të përcaktuar sipas neneve 9 dhe 10 të Konventës, do të shërbejnë, respektivisht, si Organ Ndihmës për Këshillim Shkencor dhe Teknologjik dhe Organ Ndihmës për Zbatimin e këtij

Protokolli. Dispozitat e lidhura me funksionimin e këtyre dy organeve sipas Konventës do të aplikohen *mutatis mutandis* për këtë Protokoll. Sesionet e mbledhjeve të Organit Ndhmës për Këshillim Shkencor dhe Teknologjik dhe Organit Ndhmës për Zbatimin e këtij Protokoll do të mbahen njëkohësisht me mbledhjet, respektivisht, të Organit Ndhmës për Këshillim Shkencor dhe Teknologjik dhe Organit Ndhmës për Zbatimin e Konventës.

2. Palët në Konventë që nuk janë palë e këtij Protokoll, mund të marrin pjesë si vëzhgues në punimet e çdo sesioni të organeve ndihmëse. Kur organet ndihmëse shërbejnë si organe ndihmëse të këtij Protokoll, vendimet sipas këtij Protokoll do të merren vetëm nga ata që janë palë të tij.

3. Kur organet e ndërvarura të krijuara nga nenet 9 dhe 10 të Konventës ushtrojnë funksionet e tyre në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me këtë Protokoll, çdo anëtar i Byrosë i atyre organeve të ndërvarura që përfaqëson një palë të Konventës, por në atë kohë, nuk është palë e këtij Protokoll, do të zëvendësohet nga një anëtar shtesë, që do të zgjidhet nga dhe ndërmjet palëve të këtij Protokoll.

Neni 16

Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokoll, do të shqyrtojë, sa më shpejt praktikisht, zbatimin e këtij Protokoll dhe do të modifikojë sipas mënyrës më të përshtatshme, procesin konsultativ shumëpalësh referuar nenit 13 të Konventës, në dritën e çdo vendimi përkatës që mund të merret nga Konferenca e Palëve. Çdo proces konsultativ shumëpalësh që mund të zbatohet në këtë Protokoll do të veprojë pa paragjykim në procedurat dhe mekanizmat e vendosura në përputhje me nenin 18.

Neni 17

Konferenca e Palëve, do të përcaktojë parimet, modalitetet, rregullat dhe udhëzimet përkatëse për verifikim, raportim dhe përgjegjësi për emetimet tregtare. Palët e përfshira në aneksin B mund të marrin pjesë në emetimet tregtare për qëllimet e përmbushjes së angazhimeve të tyre sipas nenit 3. Çdo tregti e tillë do të jetë shtojcë e veprimeve të brendshme me qëllim plotësimin e kufizimit të emetimeve sasiore dhe angazhimeve reduktuese sipas atij neni.

Neni 18

Konferenca e Palëve, që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokoll, në sesionin e parë do të miratojë procedura dhe mekanizma përkatës dhe efektivë për të përcaktuar dhe adresuar raste të mospërputhjes me dispozitat e këtij Protokoll, duke përfshirë përmes zhvillimit të një liste treguese të pasojave, duke marrë parasysh shkallën, tipin, shkallën dhe frekuencën e mospërputhjes. Çdo procedurë dhe mekanizëm sipas këtij neni, që sjell pasoja të detyrueshme, do të miratohet nëpërmjet ndryshimit të këtij Protokoll.

Neni 19

Dispozitat e nenit 14 të Konventës mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të zbatohen *mutatis mutandis* të këtij Protokoll.

Neni 20

1. Çdo palë mund të propozojë ndryshime të këtij Protokoll.

2. Ndryshimet e këtij Protokoll do të miratohen në një sesion të zakonshëm të Konferencës së Palëve, që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokoll. Teksti i çdo ndryshimi të propozuar të këtij Protokoll do t'u komunikohet palëve nga sekretariati të paktën gjashtë muaj përpara mbledhjes, në të cilën është propozuar për miratim. Sekretariati gjithashtu do të komunikojë tekstin e çdo ndryshimi të propozuar palëve dhe nënshkruesve të Konventës dhe për njoftim depozituesit.

3. Palët do të bëjnë çdo përpjekje për të arritur marrëveshje mbi çdo ndryshim të propozuar të këtij Protokolli me konsensus. Nëse të gjitha përpjekjet për konsensus janë ezauruar dhe nuk është arritur asnjë marrëveshje, ndryshimi si opsion i fundit do të miratohet me tri të katërtat e votave të palëve prezente dhe votuese në mbledhje. Ndryshimi i miratuar do t'i komunikohet nga sekretariati depozituesit, i cili do ta qarkullojë atë te të gjitha palët për pranimin e tyre.

4. Instrumentet e pranimi në lidhje me një ndryshim do të depozitohen te depozituesi. Një ndryshim i miratuar në përputhje me paragrafin 3 më sipër do të hyjë në fuqi për ato palë që e kanë pranuar atë në ditën e nëntëdhjetë pas datës së marrjes nga depozituesi të një instrumenti të pranimi nga të paktën tri të katërtat e palëve të këtij Protokolli.

5. Ndryshimi do të hyjë në fuqi për çdo palë tjetër në ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën ajo palë depoziton te depozituesi instrumentet e saj të pranimi të ndryshimit në fjalë.

Neni 21

1. Anekset e këtij Protokolli do të përbëjnë një pjesë integrale dhe, përveç se kur shprehimisht parashikohet ndryshe, një referencë e këtij Protokolli përbën në të njëjtën kohë një referencë të çdo aneksi. Çdo aneks i miratuar pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli do të kufizohet në listat, format dhe çdo material tjetër i një natyre shpjeguese me karakter shkencor, teknik, procedural apo administrativ.

2. Çdo palë mund të bëjë propozime për një aneks të këtij Protokolli dhe mund të propozojë ndryshime të anekseve të këtij Protokolli.

3. Anekset e këtij Protokolli dhe ndryshimet e anekseve të këtij Protokolli do të miratohen në një sesion të zakonshëm të Konferencës së Palëve që shërben si mbledhje e palëve të këtij Protokolli. Teksti i çdo aneksi apo ndryshimi të një aneksi të propozuar do t'u komunikohet palëve nga sekretariati të paktën gjashtë muaj përpara mbledhjes në të cilën ai propozohet për miratim. Sekretariati gjithashtu do t'u komunikojë tekstin e çdo aneksi apo ndryshimi të një aneksi të propozuar palëve dhe nënshkruesve të Konventës dhe, për njoftim, depozituesit.

4. Palët do të bëjnë çdo përpjekje për të arritur marrëveshje për çdo aneks apo ndryshim të një aneksi me konsensus. Nëse të gjitha përpjekjet për konsensus janë ezauruar dhe nuk është arritur asnjë marrëveshje, aneksi apo ndryshimi i një aneksi si opsion i fundit do të miratohet me tre të katërtat e votave të palëve prezente dhe votuese në mbledhje. Aneksi apo ndryshimi i një aneksi të miratuar do t'i komunikohet nga sekretariati depozituesit, i cili do ta qarkullojë atë te të gjitha palët për pranimin e tyre.

5. Një aneks apo ndryshim i një aneksi, përveç aneksit A apo B, që ka qenë miratuar në përputhje me paragrafët 3 dhe 4 të mësipërm, do të hyjë në fuqi për të gjitha palët e këtij Protokolli gjashtë muaj pas datës së komunikimit nga depozituesi këtyre palëve për miratimin e aneksit apo miratimin e ndryshimit të aneksit, përveçse për ato palë që kanë njoftuar me shkrim depozituesin, brenda asaj periudhe për mospranimin e tyre të aneksit apo ndryshimit të aneksit. Aneksi apo ndryshimi i një aneksi do të hyjë në fuqi për palët të cilat tërheqin njoftimin e tyre për mospranim ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën tërheqja e këtij njoftimi është marrë nga depozituesi.

6. Nëse miratimi i një aneksi apo ndryshimi i një aneksi përfshin një ndryshim të këtij Protokolli, ai aneks apo ndryshim i një aneksi nuk do të hyjë në fuqi për aq kohë sa ndryshimi i këtij Protokolli hyn në fuqi.

7. Ndryshimet për anekset A dhe B të këtij Protokolli do të miratohen dhe do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e vendosur në nenin 20, duke parashikuar se çdo ndryshim i aneksit B do të miratohet vetëm me miratimin e shkruar të palës përkatëse.

Neni 22

1. Çdo palë do të ketë një votë, përjashtuar rastet kur parashikohet në paragrafin 2 më poshtë.

2. Organizatat rajonale ekonomike të integruara, në çështjet brenda kompetencave të tyre,

do të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës me një numër votash të barabarta me numrin e shteteve anëtare të tyre që janë palë në këtë Protokoll. Një organizatë e tillë nuk do të ushtrojë të drejtën e saj të votës në qoftë se ndonjë nga shtetet anëtare të saj ushtron të drejtën e tij dhe anasjelltas.

Neni 23

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të jetë depozituesi i këtij Protokolli.

Neni 24

1. Ky Protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim dhe subjekt për ratifikim, pranim apo miratim nga shtete dhe organizata rajonale ekonomike të integruara të cilat janë palë në Konventë. Ai do të jetë i hapur për nënshkrim në Qendrën e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork nga 16 marsi 1998 deri më 15 mars 1999. Ky Protokoll do të jetë i hapur për aderim nga dita pas datës në të cilën ai është i mbyllur për nënshkrim. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit do të depozitohen me depozituesin.

2. Çdo organizatë rajonale ekonomike e integruar e cila bëhet palë e këtij Protokolli pa qenë një nga shtetet anëtare të saj palë, do të jetë përgjegjëse ndaj të gjitha detyrimeve të këtij Protokolli. Në rastin e këtyre organizatave, njëri apo më shumë shtete anëtare të të cilave është palë e këtij Protokolli, organizata dhe shtetet anëtare të saj do të vendosin në përgjegjësitë e tyre përkatëse për zbatimin e detyrimeve të tyre sipas këtij Protokolli. Në këto raste, organizata dhe shtetet anëtare nuk do të kenë të drejtën të ushtrojnë të drejtat sipas këtij Protokolli njëkohësisht.

3. Në instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, organizatat rajonale ekonomike të integruara do të deklarojnë shkallën e kompetencës së tyre në lidhje me çështjet e trajtuara nga ky Protokoll. Këto organizata do të njoftojnë gjithashtu depozituesin, i cili në kthim do të njoftojë palët për çdo ndryshim thelbësor në shkallën e kompetencës së tyre.

Neni 25

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën jo më pak se 55 palë të Konventës, përfshirë palët e aneksit I, të cilat përbëjnë në total të paktën 55 për qind të lëshimeve totale të dioksidit të karbonit për vitin 1990 të palëve të përfshira në aneksin I, kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit.

2. Për qëllimet e këtij neni, “emetimet e përgjithshme të dioksidit të karbonit për vitin 1990 të palëve të përfshira në aneksin I” do të thotë sasia e komunikuar në apo përpara datës së miratimit të këtij Protokolli nga palët e përfshira në aneksin I në komunikimet e tyre të para kombëtare të paraqitura në përputhje me nenin 12 të Konventës.

3. Për çdo shtet apo organizatë rajonale ekonomike të integruar që ratifikon, pranon apo miraton këtë Protokoll, apo aderon pasi kushtet e vendosura në paragrafin 1 më sipër për hyrjen në fuqi janë plotësuar, ky Protokoll do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit.

4. Për qëllimet e këtij neni, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale ekonomike e integruar nuk do të numërohet si shtesë të atyre të depozituara nga shtetet anëtare të organizatës.

Neni 26

Asnjë rezervë nuk mund t’i bëhet këtij Protokolli.

Neni 27

1. Në çdo kohë pas tre vjetësh nga data në të cilën ky Protokoll ka hyrë në fuqi për një palë, ajo palë mund të tërhiqet nga ky Protokoll duke i dhënë njoftim me shkrim depozituesit.

2. Çdo tërheqje e tillë do të ketë efekt pasi të kalojë një vit nga data e marrjes nga

depozituesi të njoftimit të tërheqjes, apo në një datë të mëvonshme që mund të specifikohet në njoftimin e tërheqjes.

3. Çdo Palë që tërhiqet nga Konventa do të konsiderohet gjithashtu që është tërhequr edhe nga ky Protokoll.

Neni 28

Originali i këtij Protokolli, tekstet në gjuhët arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle të cilat janë autentikisht të njëjta, do t'i depozitohen Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Bërë në Kioto, më 11 dhjetor 1997.

Si dëshmi, të poshtëshënuarit, të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Protokoll në datën e caktuar.

ANEKSI A

Gaze të serrave

Dioksid karboni (CO₂)

Metan (CH₄)

Oksid azoti (N₂O)

Hidrofluorokarbonet (HFCs)

Perfluorokarbon (PFCs)

Hekzafluorid Sulfuri (SF₆)

Kategori sektorësh/burimi

Energji

Djegje karburanti

Industri energjie

Industri përpunimi dhe ndërtimi

Transport

Sektorë të tjerë

Të tjera

Lëshime gazi nga karburanti

Karburante të ngurta

Naftë dhe gaz natyror

Të tjera

Procese industriale

Prodhime minerale

Industri kimike

Prodhim metali

Prodhim tjetër

Prodhim të halokarboneve dhe hekzafluorid sulfuri

Konsumi i halokarboneve dhe hekzafluorid sulfuri

Të tjera

Përdorim i solvenit dhe prodhim tjetër

Bujqësi

Fermentim i brendshëm

Menaxhim i plehrave organike

Kultivim orizi

Toka bujqësore

Djegje përshkruese e savanave

Djegje në fushë e mbetjeve bujqësore

Të tjera

Mbetje

Asgjësimi i mbetjeve të ngurta mbi tokë

Trajtimi i mbetjeve ujore
Djegia e mbetjeve
Të tjera

ANEKSI B
KUFIZIMI I EMETIMIT SASIOR OSE ANGAZHIMIT REDUKTUES TË PALËS
Palë

(PËRQINDJA E VITIN APO PERIUDHËS BAZË)

Australia	108
Austria	92
Belgjika	92
Bullgaria*	92
Kanada	94
Kroacia*	95
Republika Çeke*	92
Danimarka	92
Estonia*	92
Komuniteti European	92
Finlanda	92
Franca	92
Gjermania	92
Greqia	92
Hungaria*	94
Islanda	110
Irlanda	92
Italia	92
Japonia	94
Letonia*	92
Lihtenshtein	92
Lituania*	92
Luksemburgu	92
Monako	92
Holanda	92
Zelanda e Re	100
Norvegjia	101
Polonia*	94
Portugalia	92
Rumania*	92
Federata Ruse*	100
Sllovakia*	92
Sllovenia*	92
Spanja	92
Suedia	92
Zvicra	92
Ukraina*	100
Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut	92
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	93

* Shtetet që janë duke kaluar procesin drejt ekonomisë së tregut.

LIGJ
Nr.9335, datë 16.12.2004

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN NDRYSHUES TË
KONVENTËS EUROPIANE PËR TELEVISIONIN NDËRKUFITAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 shkronja “b” të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Protokollin Ndryshues të Konventës Europiane për Televizionin Ndërkufitar.

Neni 2

Republika e Shqipërisë, në përputhje me paragrafin e dytë të shkronjës “a” të nenit 19 të Konventës, deklaron se autoriteti zbatues i Konventës Europiane për Televizionin Ndërkufitar dhe të Protokollit Ndryshues të saj është Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4446, datë 10.1.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

PROTOKOLL AMENDUES
I KONVENTËS EUROPIANE PËR TELEVISIONIN NDËRKUFITAR

Me hyrjen në fuqi më 1 mars 2002, ky protokoll bëhet pjesë përbërëse e Konventës (CETS nr. 132).

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe palët e tjera të Konventës Europiane për televizionin ndërkufitar të hapur për nënshkrim në Strasburg më 5 maj 1989 (më poshtë quhet “Konventa”),

duke përshëndetur faktin se zgjerimi i anëtarësisë së Këshillit të Europës qysh nga viti 1989 ka çuar në zhvillimin dhe zbatimin në nivel mbareuropian të kuadrit ligjor të parashikuar në bazë të Konventës;

duke vlerësuar zhvillimet e rëndësishme teknologjike dhe ekonomike në fushën e transmetimit televiziv, si dhe daljen e shërbimeve të reja të komunikimit në Europë qysh nga miratimi i Konventës në vitin 1989;

duke vërejtur se këto zhvillime kërkojnë rishikimin e dispozitave të Konventës;

duke pasur parasysh, në këtë aspekt, miratimin nga Komuniteti Europian të Direktivës 97/36/EC së Parlamentit Europian dhe të Këshillit të 19 qershorit 1997, që ndryshon Direktivën e Këshillit 89/552/EEC për bashkërendimin e disa dispozitave të përcaktuara me ligj, rregullimin ose

veprimin administrativ të shteteve anëtare në lidhje me ndjekjen e veprimtarive të transmetimit televiziv;

duke pasur parasysh nevojën urgjente për të ndryshuar disa dispozita të Konventës me qëllim që të zhvillohet një mënyrë koherente e televizionit ndërkufitar mes këtij dokumenti dhe Direktivës, siç nënvizohet në deklaratën për mediat në një shoqëri demokratike të miratuar nga ministrat e shteteve pjesëmarrëse në Konferencën e 4-të Europiane Ministre për Politikën e Masmediave (Pragë, 7-8 dhjetor 1994) dhe në deklaratën politike të Konferencës së 5-të Europiane Ministre (Selanik, 11-12 dhjetor 1997);

me dëshirën për të zhvilluar më tej parimet e mishëruara në rekomandimet e Këshillit të Europës për hartimin e strategjive për të luftuar duhanin, alkoolin dhe vartësinë nga lëndët narkotike në bashkëpunim me opinionistët dhe mediat, për të drejtën për të dhënë lajm për veprimtari të rëndësishme, ku të drejtat e veçanta për transmetimin e tyre televiziv janë marrë në një kuadër ndërkufitar dhe për përshkrimin e dhunës në mediat elektronike, që janë miratuar në kuadrin e Këshillit të Europës qysh nga miratimi i Konventës,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Fjala “juridiksion” në nenin 8 paragrafi 1 dhe në nenin 16 paragrafi 2a të tekstit frëngjisht, duhet të zëvendësohet me fjalën “kompetencë”.

Neni 2

Fjala “reklama” në nenin 15 paragrafët 3 dhe 4 të tekstit anglisht, duhet të zëvendësohet me fjalën “dhënie e reklamave”.

Neni 3

Përcaktimi i “transmetuesit” në nenin 2 paragrafi c, duhet të formulohet si më poshtë:

c. “Transmetuesi” nënkupton personin fizik ose juridik që ka përgjegjësi editoriale për përmbajtjen e shërbimeve të programeve televizive që merr publiku i gjerë dhe i transmeton ose transmetohen, të plota dhe të pandryshuara, nga një palë e tretë.”

Neni 4

Përcaktimi i “reklamës” në nenin 2 paragrafi f, duhet të formulohet si më poshtë:

f. “Dhënia e reklamave” nënkupton çdo njoftim publik kundrejt pagesës apo një gjykimi të ngjashëm apo për qëllime vetëpromovuese, që ka për qëllim të nxisë shitjen, blerjen ose dhënien me qira të një produkti ose shërbimi, për të çuar përpara një kauzë ose një ide, ose për të shkaktuar ndonjë efekt tjetër të dëshiruar nga agjenti i reklamave ose vetë transmetuesi”.

Neni 5

Një paragraf i ri “g”, që lexon si më poshtë, duhet të shtohet në nenin 2:

g. “Teleshitje” nënkupton oferta të drejtpërdrejta që i transmetohen publikut për të ofruar mallra ose shërbime, duke përfshirë pasuri të patundshme, të drejta dhe detyrime kundrejt pagesës”.

Neni 6

Neni 2 paragrafi g, duhet të rinumërohet si neni 2, paragrafi h dhe duhet të ketë formulimin e mëposhtëm:

“Sponsorizimi” nënkupton pjesëmarrjen e një personi fizik ose juridik, i cili nuk është i angazhuar në veprimtari transmetuese apo në prodhimin e veprave dëgjimore-shikimore, në

financimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një programi me qëllim që të promovojë emrin, markën, imazhet ose veprimtaritë e atij personi”.

Neni 7

Teksti i mëposhtëm duhet të zëvendësojë nenin 5:

“Neni 5: Detyrat e palëve transmetuese

1. Secila palë transmetuese duhet të sigurojë që të gjitha shërbimet e programeve të transmetuara nga një transmetues brenda juridiksionit të saj të përputhen me klauzolat e kësaj Konvente.

2. Për qëllimet e kësaj Konvente një transmetues brenda juridiksionit të një pale është:

- një transmetues i cili gjykohet se është vendosur tek ajo palë në bazë të paragrafit 3;
- një transmetues për të cilin zbatohet paragrafi 4.

3. Për qëllimet e kësaj Konvente, një transmetues duhet të gjykohet se vendoset te një palë, që paskëtaj do të quhet “Pala transmetuese”, në rastet e mëposhtme:

a) transmetuesi e ka zyrën qendrore tek ajo palë dhe vendimet për planet e programeve merren tek ajo palë;

b) nëse një transmetues e ka zyrën qendrore tek ajo palë, por vendimet për planet e programeve merren tek një palë tjetër, do të gjykohet që ai të vendoset te pala ku vepron një pjesë e rëndësishme e forcave të punës të angazhuara në ndjekjen e veprimtarisë transmetuese televizive; nëse një pjesë e rëndësishme e forcave të punës të angazhuara në ndjekjen e veprimtarisë transmetuese televizive vepron te secila prej këtyre palëve, transmetuesi do të gjykohet të vendoset te pala ku ai ka zyrën qendrore; nëse një pjesë e rëndësishme e forcave të punës të angazhuara në ndjekjen e veprimtarisë transmetuese televizive nuk vepron tek asnjëra prej këtyre palëve, transmetuesi do të gjykohet të vendoset te pala ku nisi në fillim transmetimin, në përputhje me sistemin ligjor të asaj pale, me kusht që të ruajë një lidhje të qëndrueshme dhe efektive me ekonominë e asaj pale;

c) nëse një transmetues e ka zyrën e vet qendrore te një palë, por vendimet për planet e programeve merren në një shtet që nuk është palë në këtë Konventë, ose anasjelltas, duhet të gjykohet që ai të vendoset te pala në fjalë, me kusht që një pjesë e rëndësishme e forcave të punës të angazhuara në ndjekjen e veprimtarisë transmetuese televizive të veprojnë tek ajo palë;

d) nëse gjatë zbatimit të kriterëve të paragrafit 3 të nenit 2 të Direktivës 97/36/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 19 qershor 1997 që ndryshon Direktivën e Këshillit 89/552/EEC për bashkërendimin e disa dispozitave të përcaktuara me ligj, rregullimin ose veprimin administrativ në shtetet anëtare në lidhje me ndjekjen e veprimtarive transmetuese televizive, gjykohet që një transmetues të vendoset në një shtet anëtar të Komunitetit Europian, duhet të gjykohet gjithashtu që ai transmetues të vendoset në atë shtet për qëllimet e kësaj Konvente.

4. Një transmetues për të cilin dispozitat e paragrafit 3 nuk janë të zbatueshme, gjykohet që të jetë brenda juridiksionit të një pale, e ashtuquajtura palë transmetuese, në rastet e mëposhtme:

a) ai përdor një frekuencë që jepet nga ajo palë;

b) ndonëse ai nuk e përdor një frekuencë të dhënë nga një palë, ai përdor kapacitetin satelitor që i përket asaj pale;

c) ndonëse ai nuk përdor as një frekuencë të dhënë nga një palë, as kapacitetin satelitor që i përket një pale, ai përdor një lidhje satelitore të vendosur tek ajo palë.

5. Nëse pala transmetuese nuk mund të përcaktohet në bazë të paragrafit 4, Komiteti i Përhershëm duhet ta shqyrtojë këtë çështje në bazë të nenit 21 paragrafi 1, kryeradha a të kësaj Konvente, me qëllim që të përcaktohet kjo palë.

6. Kjo Konventë nuk do të zbatohet për transmetuesit televizivë të paramenduar vetëm për marrje në shtetet që nuk janë palë në këtë Konventë dhe që nuk merren drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nga publiku i një ose më shumë palëve.”.

Neni 8

Neni 8 duhet të ketë formulimin e mëposhtëm:

“Neni 8: E drejta për të dhënë përgjigje

1. Secila palë transmetuese duhet të sigurojë që çdo person fizik ose juridik, pavarësisht nga kombësia ose vendi i banimit, të ketë mundësinë të ushtrojë të drejtën për të dhënë përgjigje ose për të kërkuar rregullime të tjera të krahasueshme ligjore, ose administrative në lidhje me programe të transmetuara nga një transmetues brenda juridiksionit të vet në kuptimin e nenit 5. Në mënyrë të veçantë, ajo duhet të sigurojë që koha e volitshme dhe masat e tjera për ushtrimin e të drejtës për të dhënë përgjigje, të jenë të tilla që kjo e drejtë të mund të ushtrohet në mënyrë efektive. Ushtrimi efektiv i kësaj të drejte ose rregullimeve të tjera të krahasueshme ligjore ose administrative duhet të sigurohet si përsa i përket kohës së volitshme, ashtu edhe modaliteteve.

2. Për këtë qëllim, emri i shërbimit të programit ose i transmetuesit përgjegjës për këtë shërbim programi, duhet të përcaktohet në vetë shërbimin e programit, në intervale të rregullta me anë të mjeteve të përshtatshme.”

Neni 9

Teksti i mëposhtëm duhet të zëvendësojë nenin 9:

“Neni 9: Njohja e publikut me informacionin

Secila palë duhet të shqyrtojë dhe, kur është e nevojshme, të marrë masa ligjore të tilla që të përfshijë të drejtën për të dhënë lajme për veprimtari me shumë interes për publikun, për të shmangur që e drejta e publikut për të marrë informacion të minohet për shkak të ushtrimit nga ana e një transmetuesi brenda juridiksionit të saj të të drejtave të veçanta për transmetimin ose ritransmetimin, në kuptimin e nenit 3, të një veprimtarie të tillë.”

Neni 10

Të përfshihet një nen i ri 9 bis, i formuluar si më poshtë:

“Neni 9bis: Njohja e publikut me veprimtari të një rëndësie të madhe

1. Secila palë ruan të drejtën për të marrë masa për të siguruar që një transmetues brenda juridiksionit të saj nuk transmeton vetëm veprimtaritë që nga ajo palë konsiderohen me rëndësi të madhe për shoqërinë në mënyrë të tillë që t’ia heqë një pjesë të rëndësishme të publikut të asaj pale mundësinë për t’i ndjekur këto ngjarje në transmetim të drejtpërdrejtë ose në transmetim të vonuar në televizionin e lirë. Nëse ai vepron kështu, pala e interesuar mund të hartojë një listë të veprimtarive të caktuara që ajo i konsideron me rëndësi të madhe për shoqërinë.

2. Palët duhet të sigurojnë me mjete të përshtatshme respektimin e garancive ligjore që jep Konventa për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, si dhe ku është e përshtatshme, kushtetuta kombëtare, që një transmetues brenda juridiksionit të tyre nuk ushtron të drejtat e veçanta të blera nga ai transmetues pas datës së hyrjes në fuqi të protokollit që ndryshon Konventën Europiane për televizionin ndërkufitar në mënyrë të tillë që një pjesë e rëndësishme e publikut të asaj pale tjetër të mos ketë mundësinë të ndjekë veprimtaritë që janë caktuar nga ajo palë tjetër, nëpërmjet transmetimit të plotë ose të drejtpërdrejtë, ose kur është e nevojshme ose e përshtatshme për arsye objektive në interesin publik, transmetimit të plotë ose të pjesshëm të vonuar në televizionin e lirë siç përcaktohet nga ajo palë tjetër në paragrafin 1, duke respektuar kërkesat e mëposhtme:

a) Pala që zbaton masat e cituara në paragrafin 1 duhet të hartojë një listë të veprimtarive kombëtare ose jokombëtare që konsiderohen nga ajo palë me rëndësi të madhe për shoqërinë;

b) Pala duhet ta bëjë këtë në një mënyrë të qartë dhe transparente në kohën e duhur dhe efektive;

c) Pala duhet të përcaktojë nëse këto veprimtari duhet të jepen nëpërmjet transmetimit të drejtpërdrejtë të plotë ose të pjesshëm, ose kur është e nevojshme apo e përshtatshme për arsye objektive në interesin publik, transmetimit të vonuar të plotë ose të pjesshëm;

d) Masat e marra nga pala që harton listën duhet të jenë proporcionale dhe aq të hollësishme sa ç'është e nevojshme për të bërë të mundur që palët e tjera të marrin masat e cituara në këtë paragraf;

e) Pala që harton listën duhet t'ia bëjë të ditur listën dhe masat përkatëse Komitetit të Përhershëm, afati kohor për këtë duhet të përcaktohet nga Komiteti i Përhershëm;

f) Masat e marra nga pala që harton listën duhet të jenë brenda kufizimeve të udhëzimeve të Komitetit të Përhershëm, cituar në paragrafin 3 dhe Komiteti i Përhershëm duhet të ketë dhënë mendim pozitiv për masat.

Masat e mbështetura në këtë paragraf duhet të zbatohen vetëm për ato veprimtari që botohen nga Komiteti i Përhershëm në listën vjetore të cituar në paragrafin 3 dhe për ato të drejta të veçanta të blera pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli ndryshues.

3. Një herë në vit Komiteti i Përhershëm duhet:

a) të botojë një listë afatgjatë të veprimtarive të miratuara dhe masave përkatëse të njoftuara nga palët në përputhje me paragrafin 2e;

b) të hartojë udhëzimet që duhet të miratohen nga një shumicë prej të tre të katërtave të anëtarëve, përveç kërkesave të renditura në paragrafin 2, nga pika a deri te pika e, me qëllim që të shmangë dallimet mes zbatimit të këtij neni dhe zbatimit të dispozitave përkatëse të Komunitetit Europian.”

Neni 11

Paragrafi 1 i nenit 10 duhet të ketë formulimin e mëposhtëm:

“1. Çdo palë transmetuese duhet të sigurojë, nëse është e zbatueshme dhe me mjetet e përshtatshme, që një transmetues brenda juridiksionit të saj rezervon për veprat europiane pjesën më të madhe të kohës së tij të transmetimit, përveç kohës së caktuar për lajme, veprimtari sportive, lojëra, reklama, shërbime teleteksti dhe teleshitje. Kjo kohë, duke pasur parasysh përgjegjësitë informative, edukative, kulturore dhe argëtuese të transmetuesit përpara shikuesve të vet, duhet të arrihet në mënyrë progresive, në bazë të kriterëve të përshtatshme.”

Neni 12

Paragrafi 4 i nenit 10 duhet të ketë formulimin e mëposhtëm:

“4. Palët duhet të sigurojnë se një transmetues brenda juridiksionit të tyre nuk transmeton vepra kinematografike jashtë minutazhit për të cilin është rënë dakord me mbajtësit e të drejtave.”

Neni 13

Neni i ri 10 *bis* që lexon si më poshtë, duhet shtuar:

“Neni 10 *bis*: Pluralizmi në media

Palët, në frymën e bashkëpunimit dhe ndihmës së ndërsjellë që përbën themelin e kësaj Konvente, duhet të përpiqen të shmangin që shërbimet e programeve të transmetuara ose të ritransmetuara nga një transmetues, ose çdo person tjetër juridik ose fizik brenda juridiksionit të tyre, në kuptimin e nenit 3, të rrezikojnë pluralizmin në media.”

Neni 14

Titulli i kapitullit III duhet të lexojë si më poshtë:

“Reklamat dhe teleshitja”

Neni 15

Neni 11 duhet të ketë formulimin e mëposhtëm:

“1. Reklamat dhe teleshitja duhet të jenë të drejta dhe të ndershme.

2. Reklamat dhe teleshitja nuk duhet të jenë të rreme dhe nuk duhet të paragjykojnë interesat e konsumatorëve.

3. Reklammat dhe teleshitja që u drejtohen ose përdorin fëmijët, duhet të shmangin gjithçka që ka të ngjarë të dëmtojë interesat e tyre dhe duhet të mbajnë parasysh ndjeshmëritë e tyre të veçanta.

4. Teleshitja nuk duhet t'i nxisë të vegjëlit të lidhin kontrata për shitjen ose dhënien me qira të mallrave dhe shërbimeve.

5. Porositësi i reklamave nuk duhet të ushtrojë ndonjë ndikim editorial në përmbajtjen e programeve.”

Neni 16

Neni 12 duhet të ketë formulimin e mëposhtëm:

“Neni 12: Kohëzgjatja

1. Raporti i spoteve të teleshitjes, të spoteve të reklamave dhe të formave të tjera të bërjes së reklamave, me përjashtim të hapësirave të teleshitjes në kuptimin e paragrafit 3, nuk duhet ta kalojë 20 % të kohës së transmetimit ditor. Koha e transmetimit për spotet e reklamave nuk duhet ta kalojë 15 % të kohës së transmetimit ditor.

2. Raporti i spoteve të reklamave dhe spoteve të teleshitjes brenda një ore nuk duhet ta kalojë 20 %.

3. Hapësirat e caktuara për programet e teleshitjes të transmetuara brenda shërbimeve të programeve që nuk i kushtohen vetëm teleshitjes, duhet të kenë një kohëzgjatje minimale të pandërprerë prej 15 minutash. Numri maksimal i hapësirave në një ditë duhet të jetë tetë. Kohëzgjatja e tyre e përgjithshme nuk duhet t'i kalojë tri orë në ditë. Ato duhet të përcaktohen qartë me mjete optike dhe akustike.

4. Për qëllimet e këtij neni, reklammat nuk duhet të përfshijnë:

- njoftime që bën transmetuesi në lidhje me programet e tij dhe produktet ndihmëse që burojnë drejtëpërsëdrejti nga këto programe;

- njoftime në interes publik dhe thirrje për bamirësi që transmetohen falas.”

Neni 17

Neni 13 duhet të ketë formulimin e mëposhtëm:

“Neni 13: Forma dhe paraqitja

1. Reklammat dhe teleshitja duhet të jenë të dallueshme qartë si të tilla dhe të perceptueshme, veçmas nga temat e tjera të shërbimit të programeve me mjete optike dhe/ose akustike. Në parim, spotet e reklamave dhe të teleshitjes duhet të transmetohen në blloqe.

2. Reklammat dhe teleshitja nuk duhet të përdorin teknika të nënvetëdijes.

3. Nuk duhet të lejohen reklama dhe teleshitje tinëzare, në mënyrë të veçantë paraqitja e produkteve apo shërbimeve në programe, kur kjo i shërben qëllimeve të bërjes së reklamës.

4. Reklammat dhe teleshitja nuk duhet të paraqesin, me fytyrë ose me zë, persona që rregullisht japin lajmet dhe programe të çështjeve aktuale.”

Neni 18

Teksti i mëposhtëm duhet të zëvendësojë nenin 14:

“Neni 14: Përfshirja e reklamave dhe e teleshitjes

1. Reklammat dhe teleshitja duhet të përfshihen mes programeve. Me kusht që të përmbushen kushtet në paragrafët 2-5 të këtij neni, spotet e reklamave dhe të teleshitjes mund të përfshihen gjithashtu gjatë programeve në mënyrë të tillë që të mos cenohen vlerat e programit dhe të drejtat e mbajtësve të të drejtave.

2. Gjatë programeve që përbëhen nga pjesë të mëvetësishme ose gjatë programeve sportive dhe veprimtarive të strukturuar në mënyrë të ngjashme dhe shfaqjeve që kanë intervale, spotet e reklamave dhe të teleshitjes duhet të përfshihen vetëm mes pjesëve ose gjatë intervalleve.

3. Transmetimi i veprave dëgjimore-shikimore të tilla si filmat artistikë dhe filmat e bërë për televizion (duke përjashtuar seritë, serialet, programet e lehta argëtuese dhe dokumentarët), kur kohëzgjatja e tyre është më shumë se dyzet e pesë minuta, mund të ndërpriten një herë për çdo periudhë të plotë prej dyzet e pesë minutash. Një ndërprerje e mëtejshme lejohet nëse kohëzgjatja e tyre është të paktën njëzet minuta më e gjatë se dy ose më shumë periudha të plota prej dyzet e pesë minutash.

4. Kur programet, përveç atyre që përmenden në paragrafin 2, ndërpriten me spote reklamash ose teleshitjeje, mes ndërprerjeve për reklama ose për teleshitje brenda programit duhet të kalojë një periudhë prej të paktën njëzet minutash.

5. Reklammat dhe teleshitja nuk duhet të përfshihen në asnjë transmetim të shërbesës fetare. Lajmet dhe programet për çështjet aktuale, dokumentarët, programet fetare dhe programet për fëmijë, kur kohëzgjatja e tyre e caktuar është më pak se tridhjetë minuta, nuk duhet të ndërpriten me reklama ose me teleshitje. Nëse kohëzgjatja e tyre e caktuar është tridhjetë minuta ose më shumë, duhet të zbatohet dispozita e paragrafëve të mëparshëm.”

Neni 19

Titulli i neni 15 dhe paragrafët 1-2a të këtij neni duhet të kenë formulimin e mëposhtëm:

“Neni 15: Reklammat dhe teleshitja e produkteve të veçanta

1. Reklammat dhe teleshitja për produktet e duhanit nuk duhet të lejohen.

2. Reklammat dhe teleshitja për pijet alkoolike të të gjitha llojeve duhet të përshtaten me rregullat e mëposhtme:

a) ato nuk duhet t’i drejtohen në mënyrë të posaçme të vegjëlive dhe askush që ka lidhje me konsumin e pijeve alkoolike në reklama ose teleshitje, nuk duhet të duket se është minoren.”

Neni 20

Në tekstin frëngjisht, neni 15 paragrafi 2 nënparagrafët b-e duhet të formulohen si më poshtë:

“b) ato nuk duhet ta lidhin konsumin e alkoolit me ushtrimet fizike ose me drejtimin e automjetit;

c) ato nuk duhet të sugjerojnë që pijet alkoolike kanë veti terapeutike apo që kanë efekt stimulues, sedativ apo që mund t’i zgjidhin problemet personale;

d) ato nuk duhet të inkurajojnë konsumin e tepruar të pijeve alkoolike apo të japin një imazh negativ të mungesës së tyre apo të të qenit esëll;

e) ato nuk duhet të nënvizojnë pa të drejtë përmbajtjen e alkoolit në pije.”

Neni 21

Një paragraf i ri 5 që lexon si më poshtë duhet të përfshihet në nenin 15:

“5. Teleshitja për medikamente dhe kurimin mjekësor nuk duhet të lejohet.”

Neni 22

Neni 16 do të ketë formulimin e mëposhtëm:

“Neni 16: Reklammat dhe teleshitja që drejtohen posaçërisht te një palë e vetme

1. Për të shmangur shtrembërimet në konkurrencë dhe në rrezikimin e sistemit të televizionit të një pale, reklammat dhe teleshitja që u drejtohen në mënyrë të posaçme dhe me njëfarë shpeshësie shikuesve të një pale, përveç palës transmetuese nuk duhet të shkelin rregullat e televizionit për reklama dhe teleshitje në atë palë të caktuar.

2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk duhet të zbatohen kur:

a) rregullat në fjalë bëjnë një diskriminim mes reklamave dhe teleshitjes së transmetuar nga një transmetues brenda juridiksionit të asaj pale dhe reklamave dhe teleshitjes së transmetuar nga një transmetues ose çdo person tjetër juridik ose fizik brenda juridiksionit të një pale tjetër; ose

b) palët në fjalë kanë përfunduar marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe në këtë fushë.”

Neni 23

Paragrafi 1 i nenit 18 duhet të lexohet si më poshtë:

“1. Programet nuk mund të sponsorizohen nga persona fizikë ose juridikë, veprimtaria kryesore e të cilëve është prodhimi ose shitja e produkteve, ose sigurimi i shërbimeve, reklamat dhe teleshitja e të cilëve ndalohen nga neni 15.”

Neni 24

Një paragraf i ri 2 që lexon si më poshtë duhet të përfshihet në nenin 18:

“2. Kompanitë, veprimtaria e të cilave përfshin, mes të tjerash, prodhimin ose shitjen e barnave dhe kurave mjekësore, mund të sponsorizojnë programe duke promovuar emrin, markën, imazhin ose veprimtaritë e kompanisë, duke përjashtuar citimin e barnave ose kurave të veçanta mjekësore që jepen vetëm me rekomandimin e mjekut në palën transmetuese.”

Neni 25

Paragrafi 2 i nenit 18 duhet të rinumërohet si paragrafi 3.

Neni 26

Një kapitull i ri IV *bis* që lexon si më poshtë duhet të përfshihet.

“Kapitulli IV *bis* – Shërbimet e programeve që i kushtohen vetëm vetëpromovimit ose teleshitjes.

Neni 18 *bis*: Shërbimet e programeve që i kushtohen vetëm vetëpromovimit.

1. Dispozitat e kësaj Konvente duhet të zbatohen *mutatis mutandis* për shërbimet e programeve që i kushtohen vetëm vetëpromovimit.

2. Forma të tjera reklamash duhet të lejohen për shërbime të tilla brenda kufijve të përcaktuar nga neni 12 paragrafët 1 dhe 2.

Neni 18 *ter*: Shërbimet e programeve që i kushtohen vetëm teleshitjes

1. Dispozitat e kësaj Konvente duhet të zbatohen *mutatis mutandis* për shërbimet e programeve që i kushtohen vetëm teleshitjes.

2. Forma të tjera reklamash duhet të lejohen për shërbime të tilla me kufizimet e përcaktuara nga neni 12 paragrafi (i paqartë numri në origjinal) neni 12 paragrafi 2, nuk duhet të zbatohet.”

Neni 27

Fjalja e fundit e paragrafit 4 të nenit 20 duhet të hiqet dhe paragrafi 7 i nenit 20, duhet të ketë formulimin e mëposhtëm:

“7. Në bazë të dispozitave të nenit 9 *bis* paragrafi 3b dhe neni 23 paragrafi 3, vendimet e Komitetit të Përhershëm duhet të merren me një shumicë prej tre të katërtave të anëtarëve të pranishëm.”

Neni 28

Neni 21 duhet të plotësohet si më poshtë:

“f. të japë mendime për shpërdorimin e të drejtave në bazë të nenit 24 *bis* paragrafi 2c.

2. Përveç kësaj, Komiteti i Përhershëm duhet:

a) të hartojë udhëzimet e cituara në nenin 9 *bis* paragrafi 3 b, me qëllim që të shmangë dallimet mes zbatimit të dispozitave të kësaj Konvente në lidhje me njoftimin e publikut për

veprimtari me rëndësi të madhe për shoqërinë dhe zbatimit të dispozitave përkatëse të Komunitetit European;

b) të japë mendim për masat e marra nga palët që kanë hartuar një listë të veprimtarive kombëtare ose jokombëtare që konsiderohen nga këto palë me rëndësi të madhe për shoqërinë në përputhje me nenin 9 *bis* paragrafi 2;

c) të botojë një herë në vit një listë afatgjatë të veprimtarive të miratuara dhe të masave përkatëse të njoftuara nga palët në përputhje me nenin 9 *bis* paragrafi 2e.”

Neni 29

Dy paragrafë të rinj 5 dhe 6, që lexojnë si më poshtë, duhet të përfshihen në nenin 23:

“5. Sidoqoftë, Komiteti i Ministrave, pas konsultimeve me Komitetin e Përhershëm, mund të vendosë që një amendament i caktuar të hyjë në fuqi pas skadimit të një periudhe dyvjeçare pas datës në të cilën ai u hap për pranim, nëse një palë nuk e ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për kundërshtimin ndaj hyrjes së tij në fuqi. Në rast se një kundërshtim i tillë njoftohet, amendamenti duhet të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas datës në të cilën pala në Konventë që ka njoftuar kundërshtimin ka depozituar dokumentin e saj të pranimit te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

6. Në qoftë se një amendament është miratuar nga Komiteti i Ministrave, por nuk ka hyrë ende në fuqi në përputhje me paragrafët 4 ose 5, një shtet ose Komuniteti European mund të mos e shprehë pëlqimin e vet që Konventa të jetë e detyrueshme pa pranuar në të njëjtën kohë amendamentin.”

Neni 30

Një nen i ri 24*bis*, që lexon si më poshtë, duhet të përfshihet:

“Neni 24*bis*: Shkelje të supozuara të të drejtave që jep kjo Konventë

1. Kur shërbimi i programeve të një transmetuesi është tërësisht ose kryesisht i drejtuar në territorin e një pale, përveç asaj që ka juridiksionin mbi transmetuesin (“Pala marrëse”), dhe transmetuesi ka vendosur vetë me qëllim që të shmangë ligjet në fushat që mbulon Konventa që do të zbatoheshin për të nëse ai do të ishte brenda juridiksionit të asaj pale tjetër, kjo duhet të përbëjë shpërdorim të të drejtave.

2. Kur një palë akuzon për një shpërdorim të tillë, duhet të zbatohet procedura e mëposhtme:

a) palët në fjalë duhet të përpiqen të arrijnë një zgjidhje në frymë miqësore;

b) nëse ato nuk arrijnë ta bëjnë këtë brenda tre muajve, pala marrëse duhet t’ia referojë çështjen Komitetit të Përhershëm;

c) pasi ka dëgjuar pikëpamjet e palëve në fjalë, Komiteti i Përhershëm duhet, brenda gjashtë muajve nga data në të cilën iu referua çështja, të japë një mendim nëse është kryer një shpërdorim i të drejtave dhe duhet të informojë palët e interesuara për këtë.

3. Nëse Komiteti i Përhershëm ka ardhur në përfundimin se ka ndodhur një shpërdorim i të drejtave, pala brenda juridiksionit të së cilës gjykohet se është transmetuesi duhet të marrë masat e duhura për ta korrigjuar shpërdorimin e të drejtave dhe duhet të informojë Komitetin e Përhershëm për këto masa.

4. Nëse pala brenda juridiksionit të së cilës gjykohet se është transmetuesi nuk merr masat e përcaktuara qartë në paragrafin 3 brenda gjashtë muajve, palët e interesuara duhet të nisin procedurën e arbitrazhit që parashtrohet në nenin 26 paragrafi 2 dhe në shtojcën e Konventës.

5. Një palë marrëse nuk duhet të marrë ndonjë masë kundër shërbimit të programeve në fjalë derisa të përfundojë procedura e arbitrazhit.

6. Çdo masë e propozuar ose e marrë sipas këtij neni duhet të përputhet me nenin 10 të Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.”

Neni 31

Neni 28 duhet të ketë formulimin e mëposhtëm:

“Neni 28: Marrëdhëniet mes Konventës dhe legjislacionit të brendshëm të palëve

Asgjë në këtë Konventë nuk duhet të parandalojë palët që të zbatojnë rregulla më të rrepta ose më të hollësishme se ato që parashikon kjo Konventë për shërbimet e programeve të transmetuara nga një transmetues që gjykohet se është brenda juridiksionit të tyre, në kuptimin e nenit 5.”

Neni 32

Paragrafi 1 i nenit 32 duhet të ketë formulimin e mëposhtëm:

“1. Në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton dokumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose hyrjes çdo shtet mund të deklarojë se ai rezervon të drejtën për ta kufizuar ritransmetimin në territorin e vet, vetëm në shkallën që nuk përputhet me legjislacionin e tij vendas, të shërbimeve të programeve që përmbajnë reklama për pije alkoolike në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 15 paragrafi 2 të kësaj Konvente.

Asnjë rezervë tjetër nuk mund të shprehet.”

Neni 33

Në nenin 20 paragrafi 2, neni 23 paragrafi 2, neni 27 paragrafi 1, neni 29 paragrafët 1 dhe 4, neni 24 dhe në formulën përmbyllëse, fjalët “Komuniteti Ekonomik Europian” zëvendësohen nga “Komuniteti Europian”.

Neni 34

Ky protokoll duhet të jetë i hapur për pranim nga palët e Konventës. Asnjë rezervë nuk mund të shprehet.

Neni 35

1. Ky protokoll duhet të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas datës në të cilën pala e fundit e Konventës ka depozituar dokumentin e saj të pranimit te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

2. Sidoqoftë, ky protokoll duhet të hyjë në fuqi pas skadimit të periudhës dyvjeçare pas datës në të cilën ai është hapur për pranim, në qoftë se një palë e Konventës nuk ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për kundërshtimin ndaj hyrjes së tij në fuqi. E drejta për të paraqitur një kundërshtim duhet t’u rezervohet atyre shteteve ose Komunitetit Europian që shprehën pëlqimin e tyre që Konventa të jetë e detyrueshme përpara skadimit të një periudhe tremujore pas hapjes së këtij protokollit për pranim.

3. Nëse ka njoftim për një kundërshtim të tillë, Protokollin duhet të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pas datës në të cilën pala e Konventës që ka njoftuar kundërshtimin ka depozituar dokumentin e saj të pranimit te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

4. Një palë e Konventës, në çdo kohë, mund të deklarojë se ajo do ta zbatojë Protokollin përkohësisht.

Neni 36

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës duhet t’i njoftojë shtetet anëtare të Këshillit të Europës, palët e tjera të Konventës dhe Komunitetin Europian për:

- a) depozitimin e një dokumenti të pranimit;
- b) një deklaratë të zbatimit të përkohshëm të këtij Protokollin në përputhje me nenin 35 paragrafi 4;

- c) një datë të hyrjes në fuqi të këtij protokoll në përputhje me nenin 35 paragrafët 1-3;
d) çdo veprim, njoftim ose komunikim tjetër që lidhet me këtë protokoll.

U bë në Strasburg, më 9 shtator 1998, në anglisht dhe atë frëngjisht dhe u hap për pranim më 1 tetor 1998. Të dy tekstet janë njëloj autentike dhe depozitohen me një kopje të vetme në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës u përcjell kopje të vërtetuara çdo shteti anëtar të Këshillit të Europës, palëve të tjera të Konventës dhe Komunitetit Europian.

LIGJ

Nr.9336, datë 16.12.2004

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT OPEC PËR ZHVILLIMIN NDËRKOMBËTAR PËR PROJEKTIN E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për zhvillimin ndërkombëtar për projektin e menaxhimit të burimeve ujore”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4447, datë 10.1.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

FONDI OPEC PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR NR. I KREDISË PROJEKTI I MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE MARRËVESHJA E KREDISË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT OPEC PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR

Marrëveshje, datë _____, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (këtej e tutje e quajtur Huamarrësi) dhe Fondit OPEC për zhvillim ndërkombëtar (këtej e tutje i quajtur Fondi).

Shtetet anëtare të OPEC-ut, duke qenë të ndërgjegjshme për nevojën për solidarizim ndërmjet të gjitha vendeve në zhvillim dhe për rëndësinë e bashkëpunimit financiar ndërmjet tyre dhe vendeve në zhvillim, kanë krijuar Fondin për të siguruar mbështetje financiare për vendet në zhvillim, përveç instrumenteve ekzistuese dypalëshe dhe shumëpalëshe nëpërmjet të cilave shtetet anëtare të OPEC-ut u japin ndihmë financiare vendeve të tjera në zhvillim;

Huamarrësi ka kërkuar ndihmë financiare nga Fondi për financimin e projektit të përshkruar në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje;

Huamarrësi, ndërmjet të tjerash, ka kërkuar nga Shoqata për Zhvillim Ndërkombëtar (IDA) të ndihmojë në financimin e projektit përmes dhënies së një kredie;

Bordi drejtues i Fondit ka miratuar dhënien e kredisë për Huamarrësin në shumën pesë milionë e shtatëqind mijë dollarë amerikanë (USD 5 700 000), sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Për sa më sipër, palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1 **Përkufizime**

1.01 Termat që përdoren në Marrëveshje, në qoftë se nuk kërkohet ndryshe nga konteksti, do të kenë kuptimet e mëposhtme:

a) “Fond” nënkupton Fondin OPEC për zhvillim ndërkombëtar të krijuar nga shtetet anëtare të organizatës së vendeve eksportuese të naftës sipas marrëveshjes së nënshkruar në Paris, më 28 Janar 1976, siç është ndryshuar.

b) “Menaxhimi i Fondit” nënkupton Drejtorin e Përgjithshëm të Fondit ose përfaqësuesin e autorizuar prej tij.

c) “Kredi” nënkupton kredinë e dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje.

d) “Dollar” ose “\$” nënkupton monedhën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

e) “Projekt” nënkupton projektin për të cilin është dhënë kredia, siç përshkruhet në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje dhe siç mund të ndryshohet më vonë me marrëveshje ndërmjet Huamarrësit dhe Menaxhimit të Fondit.

f) “Mallra” nënkupton pajisjet, furnizimet dhe shërbimet e kërkuara për projektin. Kostoja e mallrave do të përfshijë gjithashtu koston e importit të mallrave në territorin e Huamarrësit.

g) “Agjenci zbatuese” nënkupton Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit të Huamarrësit ose çdo agjenci tjetër, siç mund të bihet dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Menaxhimit të Fondit.

h) “Datë e mbylljes” nënkupton datën e specifikuar në ose sipas seksionit 2.10 të kësaj Marrëveshjeje.

i) “Datë efektive” nënkupton datën në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi.

Neni 2 **Kredia**

2.01 Një kredi në shumën pesë milionë e shtatëqind mijë dollarë (\$ 5 700 000) i jepet Huamarrësit nga Fondi sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

2.02 Huamarrësi do të paguajë interes prej dy e një e katërta për qind (2.25%) në vit mbi shumën principale të kredisë së tërhequr dhe të mbetur herë pas here.

2.03 Huamarrësi do të paguajë sipas rastit një tarifë shërbimi në koeficientin një për qind (1%) në vit mbi shumën principale të kredisë së tërhequr dhe të mbetur, për të përballuar shpenzimet e administrimit të kredisë.

2.04 Interesi dhe tarifa e shërbimit do të paguhet në dollarë çdo gjashtë muaj, më 15 mars dhe 15 shtator të çdo viti, në një llogari të Fondit të caktuar për këtë qëllim nga Menaxhimi i Fondit.

2.05 Pasi kjo Marrëveshje të deklarohet efektive sipas seksionit 7.01 dhe në qoftë se Huamarrësi dhe Fondi nuk do të bien dakord ndryshe, shumat e kredisë mund të tërhiqen sipas rastit për të përballuar shpenzimet e bëra pas datës 16 qershor 2004 ose që do të bëhen në data të mëvonshme në lidhje me kostot e arsyetuara të mallrave të kërkuara për projektin që do të financohen nga kredia siç përshkruhet në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe në ndryshimet e shtojcës të miratuara nga Menaxhimi i Fondit.

2.06 Vetëm në rast se Fondi bie dakord ndryshe, tërheqjet nga kredia mund të bëhen në monedha në të cilat shpenzimet e përmendura në seksionin 2.05 janë paguar ose po paguhet. Në rast se pagesa do të kërkohet në një monedhë të ndryshme nga dollari, kjo pagesë do të bëhet efektive në bazë të kostos reale të dollarit, të dhënë nga Fondi për të përballuar kërkesën. Menaxhimi i Fondit

do të veprojë si agjent i Huamarrësit në blerjen e monedhave. Tërheqjet për shpenzime në monedhën e Huamarrësit, nëse ka, do të bëhen në dollarë sipas kursit zyrtar të këmbimit në kohën e tërheqjes dhe, në mungesë të kursit të këmbimit, sipas një kursi të arsyeshëm, siç do të vendosë Menaxhimi i Fondit sipas rastit.

2.07 Të gjitha aplikimet për tërheqje do të përgatiten në përputhje me “Procedurat e disbursimit të Fondit OPEC për zhvillim ndërkombëtar” të miratuara në maj 1983, një kopje e të cilave i është dhënë Huamarrësit. Një kopje origjinale e çdo kërkesë për tërheqje do t’i dorëzohet Fondit nga përfaqësuesi i Huamarrësit, i caktuar në ose në përputhje me seksionin 8.02. Çdo kërkesë e dorëzuar në këtë mënyrë do të shoqërohet me dokumente dhe evidenca të tjera në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Menaxhimin e Fondit, që Huamarrësi ka të drejtë të tërheqë nga kredia shumë të cilën ka kërkuar dhe që shuma që do të tërhiqet do të përdoret vetëm për qëllimet e specifikuar në këtë Marrëveshje.

2.08 Huamarrësi do të ripagujë principalin e kredisë në dollarë ose në një monedhë tjetër lehtësisht të konvertueshme, të pranueshme për Menaxhimin e Fondit, në një shumë të barasvlefshme me shumën e përcaktuar në dollarë, sipas kursit të këmbimit të tregut që dominon në kohën dhe vendin e ripagimit. Ripagimi do të bëhet në tridhjetë këste të barabarta gjashtëmujore, duke filluar nga data 15 shtator 2009, pas një periudhe kohe shtesë që vazhdon deri në këtë datë, dhe më pas në përputhje me shtojcën e amortizimit në këtë Marrëveshje. Çdo këst do të jetë në shumën njëqind e nëntëdhjetë mijë dollarë (\$190 000) dhe çdo këst i tillë do të transferohet në datën e ripagimit në llogarinë e Fondit sipas kërkesës nga Menaxhimi i Fondit.

2.09 a) Huamarrësi merr përsipër të sigurojë se asnjë borxh tjetër i jashtëm nuk do të ketë prioritet mbi këtë kredi në alokimin, realizimin ose shpërndarjen nga konvertimi i monedhës të mbajtur nën kontroll ose për përfitime të Huamarrësit. Për të arritur këtë, nëse do të vihet një garanci mbi asetet publike (siç përshkruhet në seksionin 2.09 (c)), si një siguri për ndonjë borxh të jashtëm, që do të ose mund të rezultojë në një prioritet për përfitimin nga kreditori të borxhit të jashtëm në alokimin, realizimin ose shpërndarjen nga konvertimi i monedhës, garancia do të sigurojë *ipso facto*, kundrejt asnjë shpenzimi nga ana e Fondit, në mënyrë të barabartë principalin dhe tarifat mbi kredinë dhe Huamarrësi, në krijimin apo lejimin për të krijuar një garanci, do të vendosë një klauzolë për këtë qëllim; me kusht që, nëse për ndonjë arsye tjetër ligjore ose kushtetuese për të cilën garancia nuk mund të vihet në lidhje me asetet e ndonjë departamenti politik ose administrativ, Huamarrësi do të sigurojë menjëherë dhe pa asnjë shpenzim nga Fondi principalin dhe tarifat mbi kredinë me një garanci të barasvlefshme mbi asete të tjera publike të kënaqshme për Fondin.

b) Dispozita e mësipërme nuk do të ketë efekt për:

i) çdo garanci të venë mbi pasurinë, në kohën e blerjes së saj, vetëm si siguri për pagesën e çmimit të blerjes së asaj pasurie;

ii) çdo garanci të venë sipas procedurave të zakonshme të transaksioneve bankare dhe që siguron një borxh që shlyhet jo më shumë se një vit pas datës së tij.

c) Siç përdoret në këtë seksion, termi “asete publike” nënkupton asete të Huamarrësit ose të ndonjë departamenti politik ose administrativ, ose të ndonjë enti në pronësi, të kontrolluar nga, ose që vepron për llogari apo për përfitime të Huamarrësit apo të ndonjë departamenti të tij, duke përfshirë arin dhe asete të tjera të këmbimit të huaj që mbahen nga ndonjë institucion që kryen funksionet e bankës qendrore ose të fondit të stabilizimit të këmbimit, ose funksione të ngjashme për Huamarrësin.

2.10 E drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga kredia do të përfundojë më 31 dhjetor 2008, ose në një datë të mëvonshme të përcaktuar nga Menaxhimi i Fondit. Menaxhimi i Fondit do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Neni 3

Zbatimi i projektit, prokurimi

3.01 Huamarrësi do të zbatojë projektin me përpikmëri dhe efikasitet dhe në përputhje me praktika të sakta administrative, financiare dhe inxhinierike dhe do të sigurojë, sapo të jetë e

nevojshme, fondet, pajisjet, shërbimet dhe burime të tjera, përveç shumave të kredisë, të kërkuara për këtë qëllim.

3.02 Huamarrësi do të sigurojë se aktivitetet e departamenteve dhe agjencive të tij në lidhje me zbatimin e projektit janë kryer dhe koordinuar në përputhje me politika dhe procedura të sakta administrative.

3.03 a) Huamarrësi merr përsipër të sigurojë ose të marrë masat e duhura për sigurimin e mallrave të importuara që do të financohen nga kredia kundër rreziqeve që mund të ndodhin gjatë transportimit dhe livrimit në vendin e përdorimit ose instalimit dhe se çdo zhvendësim për një siguracion të tillë do të mund të paguhet në çdo monedhë që përdoret lirisht nga Huamarrësi, për të zëvendësuar apo riparuar këto mallra.

b) Në rast se nuk bihet dakord ndryshe nga Fondi, të gjitha mallrat dhe shërbimet të financuara nga shumat e kredisë do të përdoren vetëm për projektin.

c) Në rast se nuk bihet dakord ndryshe ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit, "Udhëzimet e prokurimit për kredi të dhëna nga Fondi OPEC", e miratuar më 2 nëntor 1982, një kopje e së cilës i është dhënë Huamarrësit, do të zbatohen për prokurimin e mallrave sipas kësaj Marrëveshjeje.

3.04 a) Huamarrësi do t'i dorëzojë Menaxhimit të Fondit, menjëherë pas përgatitjes, planet, specifikimet, dokumentet e kontratës dhe të ndërtimit, planin e prokurimit për projektin dhe çdo modifikim material ose shtesa, në mënyrë të hollësishme siç do të kërkohej në mënyrë të arsyetuar nga Menaxhimi i Fondit.

b) Huamarrësi:

i) do të mirëmbajë regjistrime dhe procedurat e duhura për të regjistruar dhe monitoruar ecurinë e projektit (përfshirë koston dhe përfitimet që rrjedhin prej tij), do të identifikojë mallra dhe shërbime që do të financohen nga kredia dhe do të bëjë të njohur përdorimin e tyre në projekt;

ii) do të bëjë të mundur që përfaqësuesit e Menaxhimit të Fondit të vizitojnë terrenet e ndërtimit të përfshira në projekt dhe të shqyrtojnë mallrat dhe punimet e financuara nga kredia, si dhe çdo regjistrim dhe dokument përkatës;

iii) do t'i dorëzojë Menaxhimit të Fondit në intervale kohe të rregullta të gjithë informacionin që Menaxhimi i Fondit do të kërkojë në mënyrë të arsyetuar në lidhje me projektin, koston dhe, sipas nevojës, përfitimet që rrjedhin prej tij, shpenzimet nga shumat e kredisë dhe mallrat, punimet dhe shërbimet të financuara nga këto shuma, si dhe një raport tremujor mbi ecurinë e zbatimit të projektit.

c) Menjëherë pas përfundimit të projektit, por në çdo rast jo më vonë se 6 muaj pas datës së mbylljes ose një datë të mëvonshme, për të cilën mund të bihet dakord midis Huamarrësit dhe Menaxhimit të Fondit, Huamarrësi do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Menaxhimit të Fondit një raport, në qëllim dhe përmbajtje siç do të kërkohej nga Menaxhimi i Fondit, mbi zbatimin dhe shfrytëzimin fillestar të projektit, shlyerjen e detyrimeve përkatëse sipas kësaj Marrëveshjeje nga Huamarrësi dhe Fondi dhe përmbushjen e qëllimeve të kredisë.

3.05 Huamarrësi do të mbajë regjistrimet e duhura për të pasqyruar, në përputhje me praktikën e sakta financiare, veprimet, burimet dhe shpenzimet në lidhje me projektin, departamentet apo agjencitë e Huamarrësit, që janë përgjegjëse për zbatimin e projektit ose të një pjese të tij dhe do t'i vënë këto regjistrime në dispozicion të Menaxhimit të Fondit sipas kërkesës.

3.06 a) Huamarrësi dhe Fondi do të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar përmbushjen e qëllimeve të kredisë.

b) Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Menaxhimin e Fondit për situata që prekin ose kërcënojnë të prekin ecurinë e projektit, për përmbushjen e detyrimeve sipas Marrëveshjes ose përmbushjen e qëllimeve të kredisë.

c) Huamarrësi dhe Fondi, me kërkesë të çdo pale, do të shkëmbejnë pikëpamje ndërmjet përfaqësuesve në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me projektin dhe kredinë.

3.07 Të gjitha referencat ndaj Huamarrësit në këtë nen do të përfshijnë, në mënyrë të dyanshme, referencat ndaj agjencisë zbatuese.

Neni 4 **Përfshirje**

4.01 Kjo Marrëveshje dhe çdo marrëveshje shtesë ndërmjet palëve të saj do të përfshihet nga taksat, tatimet apo detyrimet e vëna nga, ose në territorin e Huamarrësit, mbi ose në lidhje me zbatimin, livrimin apo regjistrimet sipas Marrëveshjes.

4.02 Principali, interesi dhe tarifat e shërbimit mbi kredinë do të paguhet pa zbritje për dhe të përfshiuara nga tarifa apo kufizime të çdo lloji të vendosura nga ose në territorin e Huamarrësit.

4.03 Të gjithë dokumentet e Fondit, regjistrimet, korrespondenca dhe materiale të ngjashme do të konsiderohen si konfidenciale nga Huamarrësi, nëse nuk bihet dakord ndryshe nga Fondi.

4.04 Fondi dhe asetet e tij nuk do t'u nënshtrohen masave të shpronësimit, nacionalizimit, sekuestrimit, bllokimit apo përvetësimit në territorin e Huamarrësit.

Neni 5 **Përfshirja e afatit të kthimit, pezullimi dhe anulimi**

5.01 Nëse një nga ngjarjet e mëposhtme ndodh ose vazhdon për periudhën e specifikuar më poshtë, atëherë në çdo moment gjatë vazhdimin të ngjarjes, Menaxhimi i Fondit mund të deklarojë, duke njoftuar dhe Huamarrësin, pagesën e menjëhershme të principalit të mbetur të kredisë, bashkë me interesat dhe tarifat e shërbimit mbi të; në këtë rast, principali i mbetur i kredisë bashkë me interesat dhe tarifat e shërbimit do të paguhet menjëherë:

a) Ndodh një dështim që vazhdon për një periudhë prej 30 ditësh në pagesën e një kësti të principalit ose të interesit, ose të tarifave të shërbimit sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas ndonjë marrëveshjeje tjetër nëpërmjet së cilës Huamarrësi ka marrë një kredi nga Fondi;

b) Ndodh një dështim në përmbushjen e ndonjë detyrimi nga ana e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjes së projektit, nëse ka, i cili vazhdon për një periudhë prej 60 ditësh pas njoftimit që Fondi i jep Huamarrësit.

5.02 Huamarrësi, duke njoftuar Fondin, mund të anulojë çdo shumë të kredisë, të cilën Huamarrësi nuk e ka tërhequr para dhënies së njoftimit. Fondi, duke njoftuar Huamarrësin, mund të pezullojë ose t'i japë fund së drejtës së Huamarrësit për të bërë tërheqje nga kredia, nëse ndodh ndonjë nga ngjarjet e përmendura në seksionin 5.01 (a) dhe (b) ose nëse e drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga kredia e IDA-s të përmendur në parathënien e kësaj Marrëveshjeje është pezulluar ose anuluar, ose ndodh ndonjë ngjarje e jashtëzakonshme që do të pengojë zbatimin me sukses të projektit ose Huamarrësin për të shlyer detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

5.03 Të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë me fuqi dhe efekt të plotë, përveçse kur specifikohet në këtë nen, pavarësisht nga përfshirja e afatit të kthimit të kredisë sipas seksionit 5.01 ose pezullimit apo anulimit të saj sipas seksionit 5.02.

5.04 Çdo anulim do të ketë efekt në raport me kthimet e shumës principale të kredisë që do të paguhet pas datës së anulimit, nëse nuk bihet dakord ndryshe midis Huamarrësit dhe Menaxhimit të Fondit.

Neni 6 **Fuqia, ndërprerja e fondit, arbitrazhi**

6.01 Të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë Marrëveshje do të jenë të vlefshme dhe në fuqi në përputhje me kushtet e tyre, pavarësisht nga legjislacioni i brendshëm që bie në kundërshtim. Asnjë nga palët e Marrëveshjes nuk ka të drejtë, në asnjë rrethanë, të ngrejë pretendimin se ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme dhe e pafuqishme për ndonjë arsye.

6.02 Menaxhimi i Fondit do të njoftojë menjëherë Huamarrësin kur merret një vendim për shkrirjen e Fondit, në përputhje me marrëveshjen e themelimit të Fondit. Në rast shkrirjeje, kjo Marrëveshje kredie mbetet në fuqi dhe Menaxhimi i Fondit do të njoftojë Huamarrësin për marrëveshjet zëvendësuese për ripagimin e kredisë, siç mund të jetë përcaktuar nga autoriteti përkatës i Fondit për një rast të tillë.

6.03 Palët e kësaj Marrëveshjeje do të përpqen të zgjidhin miqësisht të gjitha mosmarrëveshjet ose divergjencat ndërmjet tyre, që rrjedhin nga, ose në lidhje me këtë Marrëveshje. Nëse mosmarrëveshja apo divergjenca nuk mund të zgjidhet miqësisht, ajo do të adresohet për arbitrazh nga Gjykata e Arbitrazhit siç specifikohet më poshtë:

a) Procedurat për arbitrazh mund të ngrihen nga Huamarrësi ndaj Fondit ose e anasjellta. Në të gjitha rastet, procedurat për arbitrazh do të fillojnë me një njoftim nga pala që ankohet ndaj palës së paditur.

b) Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga tre gjykatës të përzgjedhur si më poshtë: i pari nga pala ankuese, i dyti nga pala e paditur dhe i treti (që këtej e tutje i quajtur Gjykatësi) me marrëveshje ndërmjet dy gjykatësve. Nëse brenda 30 ditësh nga njoftimi i institucionit të arbitrazhit pala e paditur dështon të zgjedhë një gjykatës, ky gjykatës do të zgjidhet nga presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesën e palës që ka filluar procedurat. Nëse dy gjykatësit dështojnë të bien dakord për Gjykatësin brenda 60 ditësh pas datës së zgjedhjes së gjykatësit të dytë, Gjykatësi do të zgjidhet nga presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

c) Gjykata e Arbitrazhit do të ndërhyjë në kohën dhe vendin e caktuar nga Gjykatësi. Më pas, do të vendosë ku dhe kur do të zhvillohet. Gjykata e Arbitrazhit do të caktojë çështjet për procedurë dhe çështjet që kanë të bëjnë me kompetencat e saj.

d) Të gjithë vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të merren me shumicë votash. Vendimi i Gjykatës, që mund të merret edhe nëse njëra prej palëve tërhiqet nga procesi, do të jetë përfundimtar dhe detyrues për palët.

e) Njoftimi ose procesi, në lidhje me procedurat e përmendura në këtë seksion ose në lidhje me procedurat për të sjellë në fuqi vendimin e marrë sipas këtij seksioni, do të bëhet në mënyrën e përcaktuar në seksionin 8.01.

f) Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë për mënyrën sipas së cilës do të përballohen shpenzimet e arbitrazhit nga njëra apo të dyja palët në mosmarrëveshje.

Neni 7

Data efektive, përfundimi i Marrëveshjes

7.01 Kjo Marrëveshje do të bëhet efektive në datën kur Fondi do t'i japë Huamarrësit njoftimin e pranimit të provës së kërkuar nga seksionet 7.02 dhe 7.03.

7.02 Huamarrësi do t'i dërgojë Fondit prova të kënaqshme se:

a) Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit është autorizuar dhe ratifikuar sipas të drejtave kushtetuese të Huamarrësit;

b) Marrëveshja e kredisë në lidhje me kredinë e IDA-s, të përmendur në parathënien e kësaj Marrëveshjeje, është deklaruar efektive ose do të deklarohet efektive njëkohësisht me këtë Marrëveshje.

7.03 Në vazhdim të seksionit 7.02, Huamarrësi do t'i dorëzojë Fondit një certifikatë të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë ose Prokurori i Përgjithshëm, ose departamenti ligjor i qeverisë, që vërteton se kjo Marrëveshje është autorizuar dhe ratifikuar nga Huamarrësi dhe përbën një angazhim të vlefshëm dhe detyrues për Huamarrësin në përputhje me kushtet e saj.

7.04 Nëse kjo Marrëveshje nuk ka hyrë në fuqi dhe nuk është bërë efektive deri më _____, kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve do të përfundojnë, në rast se Fondi, pas marrjes në konsideratë të arsyeve të vonësës, nuk do të caktojë një datë të mëvonshme për qëllimet e këtij seksioni.

7.05 Kur e gjithë shuma principale e kredisë do të jetë ripaguar dhe interesat dhe të gjitha tarifat që rrjedhin nga kredia do të jenë paguar, kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve do të përfundojnë menjëherë.

Njoftimi, përfaqësimi, modifikimi

8.01 Çdo njoftim ose kërkesë e bërë ose e lejuar të jepet sipas kësaj Marrëveshjeje, do të bëhet me shkrim. Një njoftim ose kërkesë e tillë do të konsiderohet e dhënë ose e bërë siç duhet kur i dërgohet dorazi, me postë ose me telefax palës së cilës i duhet dhënë ose bërë, në adresën e palës të specifikuar më poshtë ose në çdo adresë tjetër të dhënë me shkrim nga pala tjetër palës që jep njoftimin ose bën kërkesën.

8.02 Çdo masë e kërkuar ose e lejuar për t'u marrë dhe çdo dokument i kërkuar ose i lejuar për t'u ekzekutuar sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit do të merret ose ekzekutohet nga Ministri i Financave i Huamarrësit ose nga një zyrtar tjetër i autorizuar prej tij me shkrim.

8.03 Çdo përmirësim i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje mund të miratohet në emër të Huamarrësit me shkrim nga përfaqësuesi i Huamarrësit i caktuar nga, ose sipas seksionit 8.02; me kusht që, sipas mendimit të këtij përfaqësuesi, përmirësimi të jetë i arsyeshëm për rrethanat dhe nuk do të rrisë ndjeshëm detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes.

8.04 Çdo dokument i dërguar sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë në gjuhën angleze. Dokumentet në një gjuhë tjetër do të shoqërohen me përkthim në anglisht të vërtetuar si përkthim i miratuar dhe ky përkthim do të jetë përfundimtar ndërmjet palëve.

Në prani të palëve, që veprojnë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, nënshkruhet kjo Marrëveshje në Vjenë në dy kopje origjinale me të njëjtën vlerë dhe pasojë në gjuhën angleze, në ditën dhe vitin e shënuar më lart.

SHTOJCA

Shtojca 1: Përshkrimi i projektit

Shtojca 2: Alokimi i kredisë

Shtojca 3: Grafiku i amortizimit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROJEKTI I MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

SHTOJCA 1

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti është për rehabilitimin dhe përmirësimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit në Shqipëri dhe synon rritjen e ujitjes, rritjen e ekonomisë së vendit, veçanërisht bujqësisë. Projekti përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:

a) Rehabilitimi i sistemit:

i) Rehabilitimi dhe përmirësimi i sistemit të ujitjes, për të përballuar kërkesat e shoqatave të përdoruesve të Ujit (SHPU) dhe federatave të tyre (FSHPU) sipas parimeve të orientuara nga kërkesat dhe procedurave të ndjekura gjatë projektit të mëparshëm. Fermerët duhet të organizohen në SHPU, të nënshkruajnë marrëveshjet e transferimit dhe të mbledhin kontributin e kërkuar nga anëtarët.

ii) Rehabilitimi dhe përmirësimi i sistemit të kullimit dhe kontrollit të përmytjeve dhe mekanizmave të kontrollit të përmytjeve, që do të identifikohen gjatë zbatimit të projektit. Nga projekti do të përfitohen afërsisht 30 000 ha.

iii) Rehabilitimi i rezervuarëve dhe veprave të marrjes, sigurimi dhe punimet rehabilituese për të gjithë rezervuarët më të rëndësishëm të skemave, që i janë nënshtruar inspektimit të një specialisti të huaj të kualifikuar për digat. Këto punime do të përfshijnë stabilizimin e argjinaturës, ngritjen e kreshtës, mbrojtjen nga erozioni, riparime ose zmadhime të shkarkuesit dhe riparime të veprave të daljes.

iv) Projektimi dhe supervizioni që mbulon kontratat me inxhinierë konsulentë privatë për mbikëqyrje në fushë dhe projektim dhe supervision të ndërtimit.

v) Zbatimi i planit të monitorimi të ambientit (PMA), që financon ndihmën teknike, shërbimet konsulente dhe një program monitorimi që përfshin prokurimin dhe testimin e pajisjeve. Do të sigurohet ndihmë teknike për programin e trajnimit për prezantimin e praktikave më të mira bujqësore dhe monitorimin e mjedisit.

vi) Hartimi i një programi investimesh për fazën II dhe III (Vlerësimi i mjedisit dhe siguria e digave), punimet rehabilituese do të kryhen sipas këtij programi. Ndërsa janë identifikuar skemat për fazën I, skemat e fazave II dhe III do të identifikohen dhe përzgjidhen sipas procedurave të përcaktuara në planin e zbatimit të projektit.

b) Mbështetja institucionale për ujitjen, kullimin dhe sektorin e menaxhimit të përmytjeve, që siguron mbështetje për forcimin institucional duke vazhduar procedurat e zbatuara gjatë projektit të mëparshëm për trajnimin e SHPU – ve; forcimin e bordeve të kullimit dhe Unionit Kombëtar të SHPU-ve, si dhe forcimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit (Departamentit të Menaxhimit të Ujërave) për të siguruar kapacitet të përshtatshëm për mbikëqyrjen e veprimtarisë së SHPU-ve dhe bordeve të kullimit.

c) Mbështetja institucionale për menaxhimin e burimeve ujore, duke përmirësuar kuadrin ligjor dhe institucional; vlerësimin e zonave që kërcënohen nga përmytjet; duke mbështetur rregullimin e programit të sigurisë së digave, si dhe duke mbështetur administrimin e baseneve të lumenjve dhe rrjeteve hidrometrike dhe masat e cilësisë së ujit.

d) Administrimi i projektit dhe mbështetja në zbatim, duke siguruar ndihmë teknike për Njësinë e Menaxhimit të Projektit (PMU), që përfshin një specialist vendas të menaxhimit financiar, një specialist prokurimi për të asistuar në procedurat e tenderimit ndërkombëtar, inxhinierë të specializimeve të ndryshme për të asistuar në përgatitjen e specifikimeve teknike dhe inspektimeve të specializuara në lidhje me prokurimin ndërkombëtar, një specialist të monitorimit dhe vlerësimit për të zhvilluar një sistem të përshtatshëm monitorimi dhe informacioni për PMU-në, pagat e stafit, pajisjet dhe automjetet e nevojshme për të mirëmbajtur eficientë e PMU-së.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PROJEKTI I MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

SHTOJCA II ALOKIMI I KREDISË

1. Nëse nuk bihet dakord ndryshe ndërmjet Huamarrësit dhe Menaxhimit të Fondit, tabela e mëposhtme përcakton komponentët që do të financohen nga kredia, alokimin e shumave të kredisë për çdo komponent dhe përqindjen e shpenzimeve totale për zërat që do të financohen në lidhje me çdo komponent:

Komponenti	Shuma e kredisë së alokuar (E shprehur në USD)	Përqindja e shpenzimeve totale që do të financohen
a) Rehabilitimi i sistemit	5 400 000	16.0
b) Mbështetja institucionale për ujitjen, kullimin dhe sektorin e menaxhimit të kontrollit të përmytjeve	---	--
c) Mbështetja institucionale për menaxhimin e burimeve ujore	---	--
d) Administrimi i projektit dhe mbështetja në zbatim	300 000	11.1
Totali:	5 700 000	

Pavarësisht nga alokimi i një shume të kredisë ose përqindjes së disbursimit të përcaktuar në tabelë në paragrafin 1 më lart, nëse Menaxhimi i Fondit ka vlerësuar në mënyrë të arsyetuar se shuma e kredisë së alokuar për njërin prej komponentëve do të jetë e pamjaftueshme për të financuar përqindjen e rënë dakord të të gjitha shpenzimeve për këtë komponent, Menaxhimi i Fondit, duke njoftuar Huamarrësin, mund (i) të bëjë rialokim për këtë komponent, deri në masën e kërkuar për të përballuar mungesën e vlerësuar, shumat e kredisë të cilat janë alokuar për një komponent tjetër dhe që, sipas mendimit të Menaxhimit të Fondit, nuk nevojiten për shpenzime të mëtejshme; dhe (ii) nëse një rialokim i tillë nuk mund të përballojë mungesën e vlerësuar, të pakësojë përqindjen e disbursimit që të ketë efekt, këtyre shpenzimeve me qëllim që tërheqjet e mëtejshme në lidhje me këtë komponent mund të vazhdojnë deri sa të jenë bërë të gjitha shpenzimet nën të.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROJEKTI I MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

SHTOJCA III
GRAFIKU I AMORTIZIMIT

Data e Ripagimit paguar	Shuma për t'u (e shprehur në USD)
15 shtator 2009	190,000
15 mars 2010	190,000
15 shtator 2010	190,000
15 mars 2011	190,000
15 shtator 2011	190,000
15 mars 2012	190,000
15 shtator 2012	190,000
15 mars 2013	190,000
15 shtator 2013	190,000
15 mars 2014	190,000
15 shtator 2014	190,000
15 mars 2015	190,000
15 shtator 2015	190,000
15 mars 2016	190,000
15 shtator 2016	190,000
15 mars 2017	190,000
15 shtator 2017	190,000
15 mars 2018	190,000
15 shtator 2018	190,000
15 mars 2019	190,000
15 shtator 2019	190,000
15 mars 2020	190,000
15 shtator 2020	190,000
15 mars 2021	190,000
15 shtator 2021	190,000
15 mars 2022	190,000
15 shtator 2022	190,000
15 mars 2023	190,000
15 shtator 2023	190,000
15 mars 2024	190,000
Totali: 5 700 000	

DEKRET
Nr.4440, datë 29.12.2004

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---|------------------------------------|
| 1. Alfred Muço Mançe | 20. Rajmonda Iljas Aliçka |
| 2. Jürgen Alfred Mançe | 21. Liridona Ardjan Aliçka |
| 3. Richard Alfred Mançe | 22. Admir Zyhdi Kruja |
| 4. Etleva Hiqmet Mançe(Gërbaj) | 23. Gjergj Zef Mazi |
| 5. Amarilda Bashkim Vulka | 24. Drita Ramadan Ymeri (Kumbulla) |
| 6. Flora Anesti Paskali | 25. Ergys Luan Ymeri |
| 7. Ilda Isuf Lleshi (Çela) | 26. Erjon Luan Ymeri |
| 8. Leonard Argjend Kacanja | 27. Alfred Përparim Metohu |
| 9. Lulzim Nuri Hyseni | 28. Ina Alfred Metohu |
| 10. Patrick Lulzim Hyseni | 29. Besnik Miri Kalo |
| 11. Mamica Gani Hyseni (Abazaj) | 30. Sarah-Noëlle Besnik Kalo |
| 12. Toni Lulzim Hyseni | 31. Aida Namik Kalo (Agolli) |
| 13. Arben Bahir Vrapì | 32. Edmond Selfo Feçanji |
| 14. Armida Arben Vrapì | 33. Arben Hetem Sinani |
| 15. Sabrina Arben Vrapì | 34. Astrit Sadik Malko |
| 16. Mimoza Petro Vrapì (Jançe) | 35. Kamila Astrit Malko |
| 17. Alma Trëndafil Wittkowski (Çelanji) | 36. Alwin Astrit Malko |
| 18. Besnik Eqrem Trungu | 37. Ermira Veli Malko (Shano) |
| 19. Aurora Fatmir Gashi | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

Ndreqje gabimi

Në Fletoren Zyrtare nr.97/2004 në ligjin nr.9308, datë 4.11.2004, në nenin 7 pika 1, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

c) shëndetin publik veterinar;

Shkronja “c” bëhet “ç” dhe shkronja “ç” bëhet “d”.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 12.1.2005

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë